

Mevlude Aliu - Gashi  
Zehrie Plakolli

**ROLI I EDUKATORES NË ZHVILLIMIN E  
KOMUNIKIMIT VERBAL TE FËMIJËT  
PARASHKOLLORË ME VËSHTIRËSI NË TË FOLUR**





Mevlude Aliu-Gashi  
Zehrie Plakolli

ROLI I EDUKATORES NË ZHVILLIMIN E  
KOMUNIKIMIT VERBAL TE FËMIJËT  
PARASHKOLLORË ME VËSHTIRËSI NË TË FOLUR

**Prishtinë, 2023**

**Botues**  
**Instituti Pedagogjik i Kosovës**

**Roli i edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët  
parashkollorë me vështirësi në të folur**

**Autorët**  
Mevlude Aliu-Gashi  
Zehrie Plakolli

**Botues**  
**Instituti Pedagogjik i Kosovës**

**Për butuesin**  
Ismet Potera - Zvs. Drejtor

**Recensentë**  
Osman Buleshkaj  
Tringa Shpendi

**Redaktor gjuhësor**  
Bekim Morina

**Përgatitja teknike**  
Skender Mekolli

**Shtypi**  
Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë

## Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave .....	5
Lista e figurave .....	6
Lista e shkurtesave.....	7
Abstrakt .....	9
Hyrje.....	13
<b>KAPITULLI I .....</b>	<b>15</b>
<b>I. ROLI I EDUKATORES NË ZHVILLIMIN E KOMUNIKIMIT VERBAL TE FËMIJËT PARASHKOLLORË ME VËSHTIRËSI NË TË FOLUR .....</b>	<b>15</b>
1.1. Dokumentet zyrtare që mbështesin komunikimin verbal të fëmijëve në edukimin parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë .....	17
1.2. Roli i edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te të gjithë fëmijët e grupit .....	19
1.3. Strategjitë e edukatores, të cilat mbështesin komunikimin verbal të fëmijëve (3-6 vjeç) me vështirësi në të folur .....	22
1.4. Mjedisi, mjetet dhe materialet që përdor edukatorja për të nxitur komunikimin verbal te fëmijët me vështirësi në të folur.....	25
1.5. Qëllimi dhe pyetjet e hulumtimit .....	26
1.5.1. Qëllimi i hulumtimit .....	26
1.5.2. Pyetjet e hulumtimit .....	27
1.6. Metodologjia .....	27
1.7. Rezultatet e hulumtimit .....	30
1.7.1. Të dhënat e përgjithshme .....	30
1.7.2. Analiza tematike e hulumtimit – roli i edukatores, strategjitë dhe mjedisi .....	41
1.5. Konkludime dhe rekomandime .....	58

<b>KAPITULLI II .....</b>	<b>63</b>
<b>II. ROLI DHE RËNDËSIA E BASHKËPUNIMIT EDUKATORE-PRIND NË MBËSHTETJEN E FËMIJËVE ME VËSHTIRËSI NË TË FOLUR .....</b>	<b>63</b>
2.1. Konteksti teorik .....	63
2.2. Strategji mbështetëse në të folurit e fëmijës, për prindër dhe edukatore .....	67
2.3. Qëllimi .....	69
2.3.1. Pyetjet hulumtuese .....	69
2.4. Metodologjia .....	69
Mostra .....	70
Instrumentet .....	70
Procedura e mbledhjes së të dhënave .....	70
Analiza dhe interpretimi .....	70
2.5. Rezultatet e hulumtimit .....	71
2.5.1. Karakteristikat e pjesë marrësve - respondentëve (prindër dhe edukatore) .....	71
2.5.2. Të dhënat nga perspektiva e prindërve .....	72
2.5.3. Të dhënat nga perspektiva e edukatoreve .....	76
3. Konkluzione .....	83
Përfundim .....	85
Rekomandime .....	86

## Lista e tabelave

Tabela 1.	<i>Roli i edukatores dhe startegjitë që përdor në zhvillimin e komunikimit verbal me të gjithë fëmijët në grup</i>	43

## Lista e figurave

Figura 1	<i>Numri i edukatoreve të përfshira në hulumtim sipas komunave</i>	31
Figura 2	<i>Numri i edukatoreve të përfshira në hulumtim sipas Institucionit parashkollor publik dhe privat</i>	32
Figura 3	<i>Zbatimi i planit individual për fëmijët me vështirësi në komunikim verbal</i>	34
Figura 4	<i>Karakteristikat e fëmijëve me vështirësi në komunikim verbal të përfshirë në hulumtim</i>	35
Figura 5	<i>Numri i fëmijëve që janë vlerësuar dhe nuk janë vlerësuar nga profesionistët</i>	36
Figura 6	<i>Numri i rasteve sipas vlerësimit të profesionistëve</i>	37
Figura 7	<i>Numri i edukatoreve që marrin mbështetje shitesë në punën e tyre për fëmijët me vështirësi në komunikim verbal</i>	39
Figura 8	<i>Cila mbështetje shitesë (përveç edukatores) u ofrohet fëmijëve</i>	40
Figura 9	<i>Edukatorja mban kontaktin me sy me fëmijët e grupit</i>	50



## Lista e shkurtesave

<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale për Arsim
<b>IP</b>	Institucione Parashkollore
<b>IPK</b>	Instituti Pedagogjik i Kosovës
<b>KK</b>	Korniza Kurrikulare
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>OECD</b>	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
<b>UNESCO</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
<b>UA</b>	Udhëzim administrativ
<b>UNICEF</b>	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara



# ROLI I EDUKATORES NË ZHVILLIMIN E KOMUNIKIMIT VERBAL TE FËMIJËT PARASHKOLLORË ME VËSHTIRËSI NË TË FOLUR

Mevlude Aliu-Gashi  
Zehrie Plakolli

**Abstrakt** *Hulumtimi trajton problematika që lidhen me punën e edukatores, krahas zhvillimit të komunikimit verbal të fëmijëve 3-6 vjeç, në institucione parashkollore në Kosovë. Ky hulumtim është realizuar përmes dy kapitujve, nga dy autorë, dhe paraqiten rezultate dhe rekomandime specifike për secilin kapitull.*

*Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të analizojë rolin e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, të cilët kanë vështirësi në të folur. Hulumtimi, gjithashtu, identifikon strategjitë që përdorin edukatoret për të ndikuar në zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve që kanë vështirësi në të folur, por edhe rëndësinë e bashkëpunimit edukatore-prind, në funksion të qasjes së duhur ndaj fëmijëve me vështirësi në të folur. Hulumtimi karakterizohet nga qasja kualitative. Mostra është e qëllimshme. Për kapitullin e parë respondentë në hulumtim janë 34 edukatore (17 në 11 kopshte publike dhe 17 edukatore në 11 kopshte private) dhe 34 fëmijë me vështirësi në të folur. Hulumtimi është realizuar përmes vëzhgimit në klasë.*

*Për kapitullin e dytë, respondentë të hulumtimit janë 10 prindër dhe 12 edukatore. Hulumtimi është realizuar nëpërmjet intervistave gjysmë të strukturuar.*

*Rezultatet tregojnë se roli i edukatores ende nuk është në nivelin e mirë të performancës, për të arritur rezultate efektive në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët që kanë vështirësi në të folur, në institucionet parashkollore, publike dhe private, të përfshira në hulumtim. Ka mangësi, duke filluar në procesin e pranimit të fëmijëve në institucion, ngase pak fëmijëve u bëhet ndonjë vlerësim profesional, pak mbështetje ka për këta fëmijë, pastaj ka mangësi në përdorimin e strategjive të përshtatshme nga edukatoret, në përgatitjen e mjedisit të përshtatshëm dhe në bashkëpunimin e mirëfilltë edukatore-prind dhe anasjelltas.*

*Rezultatet paraqesin nevojën për zhvillim profesional të edukatoreve që të zbatojnë strategji të nevojshme për fëmijët me vështirësi në komunikim verbal, për krijimin mundësive që fëmijët me këto vështirësi të kenë identifikimin, vlerësimin dhe mbështetjen nga institucionet, prindërit dhe edukatorët që të zhvillohen gjithanshëm, e domosdo të zhvillohet komunikimi verbal i fëmijëve krahas moshës që kanë.*

**Fjalët çelës:** *edukatorët, fëmijët me vështirësi në të folur, bashkëpunimi edukatore-prindër, komunikimi verbal, strategjitë.*

# The role of educator in the development of verbal communication with pre-school children with speech difficulties

Mevlude Aliu-Gashi  
Zehrie Plakolli

**Abstract** *The research deals with issues related to the work of the educator, in addition to the development of verbal communication of children aged 3-6 years, in preschool institutions in Kosovo. This research is carried out through two chapters, by two authors, and specific results and recommendations are presented for each chapter.*

*The purpose of this research was to analyze the role of the educator in the development of verbal communication of children aged 3-6 years, who have difficulties in speaking. The research also identifies the strategies that educators use to influence the development of verbal communication of children who have speech difficulties, but also the importance of educator-parent cooperation, in function of the appropriate approach to children with speech difficulties. Research is characterized by a qualitative approach.*

*The sample is intentionally. For the first chapter, the research respondents were 34 educators (17 in 11 public kindergartens and 17 educators in 11 private kindergartens) and 34 children with speech difficulties. The research has been carried out through classroom observation.*

*For the second chapter, the research respondents were 10 parents and 12 educators. The research was carried out through semi-structured interviews.*

*The results show that the role of the educator is still not at a good level of performance, to achieve effective results in the development of verbal communication of children who have difficulty speaking, in the preschool institutions, public and private, involved in the research.*

*There are deficiencies, starting in the process of accepting children into the institution, because just a few children are given a professional evaluation, there is also a little support for these*

*children, then there are deficiencies in the use of appropriate strategies by educators, in the preparation of the appropriate environment and in real cooperation between educators and parents and vice versa.*

*The results show the need for professional development of educators to implement necessary strategies for children with difficulties in verbal communication, to create opportunities for children with these difficulties to have the identification, assessment and support from institutions, parents and educators to develop comprehensively, necessarily to develop children's verbal communication according to their age.*

*Keywords: educators, children with speech difficulties, educator-parent collaboration, verbal communication, strategies.*

**Hyrje** Vitet e fundit, edukatorët paraqesin shqetësimin se në çdo gjeneratë të fëmijëve që vijojnë institucionin parashkollor po vërehet që është në rritje numri i fëmijëve me vështirësi në komunikim verbal, ose nuk flasin fare. Kjo dukuri, sipas tyre, është në rritje. Për shkaqet, faktorët, rrethanat e shfaqjes së kësaj dukurie te fëmijët janë realizuar hulumtime psikologjike e neurologjike, që në shumë raste lidhen me ndryshimet në stilin e jetës së familjes dhe të shoqërisë, përdorimin e teknologjisë etj.

Hulumtimi trajton çështjen se cili është roli i edukatores, çfarë mbështetje u ofron ajo fëmijëve për zhvillimin e komunikimit verbal te të gjithë fëmijëve në grup, si dhe për të nxitur, motivuar dhe stimuluar zhvillimin e këtij lloji të komunikimit te fëmijët me vështirësi në të folur dhe fëmijët që për arsye të dygjuhësisë kanë vështirësi në komunikim verbal.

Sipas High Speed Training (2021), hulumtimet kanë gjetur se, në disa zona, më shumë se 50% e fëmijëve që hyjnë në fazën e të folurit kanë nivele gjuhësore nën nivelin që pritet për moshën e tyre. Që nga fillimi i pandemisë COVID-19, kjo statistikë ka të ngjarë të jetë përkeqësuar, pasi zhvillimi gjuhësor ka pësuar regres për shumë fëmijë, duke i lënë ata pas bashkëmoshatarëve të tyre (High Speed Training, 2021). Në një sërë studimesh globale, edukatorët parashkollorë kanë raportuar se shumë fëmijë kanë një zhvillim të dobët të të folurit dhe gjuhës dhe kështu kanë nevojë për mbështetje (Wills, 2011).

Promovimi i zhvillimit të gjuhës dhe komunikimit te fëmijët, sipas Tomilson & Hyson (2009), duhet të mbështetet nga të rriturit... edukatorët mund të bëjnë shumë gjëra për të pasuruar dhe zgjeruar interesin e natyrshëm të fëmijëve për gjuhën dhe komunikimin, qoftë përmes dëgjimit të vëmendshëm, bisedave të gjata, leximit të librave dhe

diskutimit të tyre, ose sigurimit të materialeve (Tomilson & Hyson, 2009).

Raporti i hulumtimit përfshin dy kapituj:

**Kapitulli I** - Roli i edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve parashkollorë me vështirësi në të folur.

Ky kapitull trajton rolin e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët në klasë dhe me fokus të veçantë strategjitë e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët që kanë vështirësi në të folur. Kapitulli trajton shqyrtimin e literaturës, qëllimin, metodologjinë dhe rezultatet e hulumtimit nga terreni, si dhe janë nxjerrë konkluzione dhe rekomandime lidhur me gjetjet për këtë temë.

**Kapitulli II** - Roli dhe rëndësia e bashkëpunimit edukatore-prind në mbështetjen e fëmijëve me vështirësi në të folur.

Në kuadër të këtij kapitulli, objektiva studimore është trajtuar në aspekt teorik dhe janë dhënë reflektime të ekspertëve të ndryshëm pedagogjikë, lidhur me rëndësinë e aftësisë të fëmijës në komunikim për zhvillimin e tij të gjithanshëm, si dhe strategjitë mbështetëse të të folurit. Kurse, nga aspekti empirik i realizimit të hulumtimit në terren janë shqyrtuar këndvështrimet e edukatoreve dhe prindërve, lidhur me ndikimin e bashkëpunimit të hapur dhe transparent të këtyre dy faktorëve, në avancimin e aftësive të komunikimit të fëmijëve me ngecje në të folur.

Rezultatet e hulumtimit ofrojnë mbështetje për edukatorët dhe prindërit, në lidhje me rolin e edukatores në mbështetjen e fëmijëve për të zhvilluar komunikimin verbal, një kompetencë që fëmijët pritet të arrijnë në moshën e caktuar dhe që ndikon në zhvillimin holistik të fëmijës.



## KAPITULLI I

### I. ROLI I EDUKATORES NË ZHVILLIMIN E KOMUNIKIMIT VERBAL TE FËMIJËT PARASHKOLLORË ME VËSHTIRËSI NË TË FOLUR

Roli i edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët parashkollorë me vështirësi në të folur është një ndër rolet e pazëvendësueshme dhe, pas rolit të prindit, ka ndikim të madh në zhvillimin e fëmijës, në të gjitha fushat e zhvillimit të e tij, përfshirë edhe zhvillimin e komunikimit verbal.

Sipas High Speed Training (2021), të folurit, gjuha dhe komunikimi, janë fusha kritike të zhvillimit të fëmijëve. Ato luajnë rol jetësor gjatë gjithë jetës sonë, duke na ndihmuar të kuptojmë se çfarë po ndodh rreth nesh, të komunikojmë nevojat dhe ndjenjat tona themelore, të zhvillojmë biseda, të mendojmë dhe të mësojmë, të zhvillojmë marrëdhënie, të zgjidhim problemet etj. Gjithashtu, mbështesin shumë aspekte të tjera të zhvillimit, duke përfshirë zhvillimin kognitiv, social dhe të shkrim-leximit (High Speed Training, 2021).

Roli i edukatores në realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin e komunikimit, sipas The Little Dreams Nursery (2022), është me shumë rëndësi për zhvillimin e fëmijëve. Shpjegimi i qartë i ideve dhe udhëzimeve është një shenjë e aftësisë së mirë komunikuese. Duke pasur një komunikim të mirë dhe zhvillim gjuhësor, i ndihmoni fëmijët të bëhen më të sigurt, të kenë aftësinë për t'u

shprehur dhe për të qenë më socialë. Këto aftësi të zhvillimit të fëmijëve për komunikimin e fëmijëve janë një domosdoshmëri (The Little Dreams Nursery, 2022).

Aktivitetet që realizon edukatorja, sipas Marshall-Seslar (2022), duhet të jenë aktivitete gjuhësore, që e bëjnë fëmijën të komunikojë verbalisht ose joverbalisht. Aktivitetet gjuhësore zhvillojnë aftësi në gjuhë pranuese (të kuptuarit e të tjerëve) dhe gjuhë shprehëse (duke komunikuar me të tjerët) (Marshall-Seslar, 2022).

I një rëndësie të veçantë në punën e edukatores dhe rolin e saj në zhvillimin e komunikimit me fëmijët është edhe vlerësimi. Sipas Gooden & Kearns (2013), më e rëndësishmja, për edukatorët, fëmijët dhe familjet, është që të ndjekin vlerësimin e detajuar për aftësitë komunikuese të fëmijëve në baza ditore. Edukatorët dhe familjet mund t'i përdorin sistemin e vlerësimit dhe raportet e tij specifike për të gjurmuar progresin dhe për të planifikuar hapat e ardhshëm për zhvillimin e fëmijëve (Gooden, C & Kearns, J., 2013).

Planifikimi i punës së edukatores, bazuar në vëzhgimin dhe vlerësimin e arritjeve të fëmijëve, i plotëson nevojat dhe interesat e secilit fëmijë, edhe të atyre me vështirësi në komunikim verbal. Sipas Illumine (2022), ka qasje të ndryshme për hartimin e planeve mësimore për parashkollorët dhe çdo edukator i kujdesit për fëmijët ka të ngjarë të testojë disa plane të ndryshme përpara se të angazhohet për një plan. Përmes qëllimeve gjuhësore në planifikim, edukatorët synojnë të ndihmojnë fëmijët të ndërtojnë një fjalor më të fortë dhe t'i ndihmojnë ata të marrin pjesë në biseda. Angazhimi në lojëra me role dhe skeçe mund të jetë një mënyrë për ta arritur këtë (Illumine, 2022).

1.1. Dokumentet zyrtare që mbështesin komunikimin verbal të fëmijëve në edukimin parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë

Çështjet që lidhen me gjuhën dhe komunikimin, si kompetencë, si fushë, si standard, si rezultat apo si përmbajtje, janë trajtuar në të gjitha dokumentet zyrtare. Po ashtu, edhe në hulumtime që trajtojnë zbatimin e tyre në praktikë, por, si çështje hulumtimi që lidhet me edukatoren dhe zhvillimin e komunikimit verbal (si një specifikë shumë e veçantë e gjuhës dhe komunikimit), në aspektin pedagogjik, nuk është bërë ndonjë hulumtim në Kosovë.

Sa u përket dokumenteve zyrtare që e mbështesin zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijët, kemi fusha të kurrikulës dhe fusha të zhvillimit të standardeve të fëmijërisë së hershme që i kushtojnë rëndësinë e duhur. Sipas Kurrikulës për edukimin parashkollor 3-6 vjeç (2006), e cila ende është në përdorim për fëmijët e moshës 3-5 vjeç, një ndër parimet e saj është: “Në institucionet parashkollore edukatorja/i gëzon lirinë pedagogjike dhe përmbush përgjegjësinë pedagogjike të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë edukative, në përshtatje me nivelin e zhvillimit të fëmijëve parashkollorë” (MASHT, 2006, f. 11). Bazuar në përbërjen e grupit të fëmijëve, nevojave, interesave dhe zhvillimit të fëmijëve të grupit, edukatorja duhet të përshtatë veprimtarinë edukative, në këtë rast edhe në komunikimin verbal të tyre. Janë përcaktuar edhe fushat e aktivitetit dhe njëra nga ato është fusha Gjuhë amtare dhe si objektiva të përgjithshme, që kanë të bëjnë me rolin e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve, janë: “Të aftësohet të komunikojë me bashkëmoshatarët dhe të rriturit, të shprehë mendimet, idetë, ndjenjat etj. dhe të zhvillojë aktivitete shtesë për përmirësimin apo zbutjen e vështirësive në të folur” (MASHT, 2006, f. 29).

Është hartuar edhe Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor (2016), që zbatohet me nxënësit e moshës 5-6 vjeç. Kjo kurrikulë e ka

kompetencën e komunikimit dhe të shprehurit (komunikues efektiv): “Për të komunikuar në mënyrë efektive, nxënësit përkrahen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative, mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të shprehurit” (MASHt, 2016, f. 19). Prandaj, është në detyrën e edukatores që fëmijët të përkrahen për mundësitë e komunikimit dhe të shprehurit.

Në Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç - SZhMFH (2011), zhvillimi i aftësive komunikuese është “vlerë bazë mbi të cilën më me lehtësi krijohen edhe vlerat e tjera” (MASHt, 2011). Ndërsa, te fusha Zhvillimi i Gjuhës dhe Komunikimit dhe nënfusha Të dëgjuarit dhe të folurit janë tri standarde që synohen të arrihen me fëmijët e moshës 3- 6 vjeç, për komunikimin verbal të tyre, e që janë “Fëmija tregon aftësi për të dëgjuar dhe kuptuar kur të tjerët flasin; Fëmija tregon aftësi për të folur dhe komunikuar; Fëmija manifeston aftësi kreative gjuhësore (shprehëse, me fjalë)” (MASHt, 2011). Për arritjen e këtyre standardeve dhe treguesve që lidhen me ato, nga fëmijët parashkollorë në institucion rol me rëndësi ka edukatorja.

Po ashtu, koncepti i gjithëpërfshirjes, si parimi kryesor që orienton gjithë procesin arsimor në të gjitha politikat aktuale të MASHtI-t, përmes dokumenteve zyrtare ofron zgjidhje të modifikueshme për t'i trajtuar dallimet e fëmijëve/nxënësve në procesin e mësimnxënies dhe nevojat e tyre të veçanta, duke kontribuar që çdo fëmije/nxënësi t'i ofrohet mundësia që të shpalosë vlerat individuale, të ndihet i pranuar, i vlerësuar dhe të përfitojë maksimalisht nga procesi mësimor (Reçica-Havolli & Mekolli, 2018).

Meqenëse hulumtimi trajton rolin e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët parashkollorë, janë të përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta, që kanë vështirësi në komunikimin verbal. Një klasë që nxit

dëshirën e fëmijëve për të komunikuar dhe e mbështet çdo lloj përpjekje të komunikimit, me qëllim të ndërveprimit social dhe zhvillimit të aftësive të tyre, është thelbësore për një klasë gjithëpërfshirëse.

**1.2. Roli i edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te të gjithë fëmijët e grupit**

Dokumentet zyrtare dhe administrative paraqesin rëndësinë dhe nevojën që edukatorja të zbatojë strategji, metoda, teknika, mjete dhe materiale të nevojshme, që fëmijët të arrijnë zhvillimin optimal të tyre dhe për të arritur kompetencat. Andaj, duke u bazuar në temën e hulumtimit, fokusi do të jetë te roli i edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te të gjithë fëmijët, veçanërisht te fëmijët që kanë vështirësi në të folur.

Sipas Swaril et al. (2020), në edukimin e fëmijërisë së hershme komunikimi është i rëndësishëm për të ndihmuar fëmijët të ndërtojnë aftësi akademike dhe të ndiejnë besim në të mësuar. Komunikimi efektiv duhet të bëhet me kuptim dhe mirëkuptim të përbashkët edukatore - fëmijë në mjediset e fëmijërisë së hershme (Swaril, Tantra, & Pratiwi, 2020).

Doracaku nga Mecce, et. al. tregon se si edukatorët duhet të krijojnë mjedis pozitiv në klasë për të zhvilluar komunikimin e mirë verbal te fëmijët... ku çdo fëmijë ndihet i veçantë dhe i kërkuar kur të rriturit i mirëpresin ngrohtësisht në klasë, çdo ditë, andaj këshillon edukatoren të marrë një moment çdo ditë për të përshëndetur çdo fëmijë me emër dhe t'u kushtojë vëmendje të plotë (Meece, Rivers & Wingate, 2009).

Edukatorët që kanë aftësi të mira sociale do të shikojnë gjuhën e trupit dhe shprehjet gojore. Andaj Wahyuni (2017) theksoi se edukatorët duhet të jenë shumë të vëmendshme që të kapin çdo reagim të mundshëm, verbal dhe joverbal, të fëmijëve gjatë komunikimit. Në këtë mënyrë, ato do ta kenë më të lehtë të vlerësojnë nevojën

dhe të nxisin komunikimin e përshtatshëm për fëmijët, duke vënë theksin në nxitjen e komunikimit verbal (Wahyuni, 2017).

Lidhur me komunikimin verbal të fëmijës, Vigotski (1987) shkroi: “Forma e parë e të folurit të fëmija është thjesht sociale”. Në këtë deklaratë të shkurtër ai kap faktin se mbijetesa njerëzore kërkon vëmendjen dhe kujdesin e vazhdueshëm ndaj të tjerëve, prandaj përpjekjet më të hershme të fëmijëve në komunikim, kërkojnë interpretime të kujdesshme dhe të akorduara mirë të ofruara nga kujdestarët: që nga momenti i lindjes, kjo përshtatje e vendos foshnjën në marrëdhënie shoqërore me të rriturit dhe nëpërmjet tyre në një sistem kuptimor socio-kulturor (Mahn & Steiner, 2012).

Sipas Foorman et al. (2015), aftësitë e komunikimit verbal të fëmijës përfshihen pothuajse në çdo aspekt të ditës në institucion parashkollor. Nga shoqërimi me bashkëmoshatarët deri te të kuptuarit e udhëzimeve nga edukatorët dhe pjesëmarrja në aktivitetet në klasë, aftësitë e komunikimit verbal janë në qendër të çdo ndërveprimi dhe ndikojnë thellësisht në suksesin në tyre (Scouten & Bardell, 2018).

Edukatorët janë pjesëmarrës aktivë dhe organizatorë të komunikimit verbal ndërmjet fëmijëve. Ato e ftojnë fëmijën t'u tregojë fëmijëve të tjerë për të rejtat e tyre, duke tërhequr vëmendjen e fëmijëve tek ai, duke i nxitur fëmijët e tjerë të bëjnë pyetje dhe deklarata dhe duke i inkurajuar ata të përgjigjen dhe të flasin (Kizi, 2020). Të gjithë fëmijët përfitojnë dukshëm nga një bisedë e qëndrueshme, me të rriturit dhe fëmijët e tjerë, veçanërisht me moshatarët, aftësitë gjuhësore të të cilëve janë më të avancuara se ato të tyre (Tomilson & Hyson, 2009). Nevoja për të përdorur mënyra të ndryshme, që mbështesin komunikimin, është e gjerë. Institucioni parashkollor luan rol vendimtar në zhvillimin e fëmijës (Brodin & Renblad, 2018). Sipas

Conde (2006), hulumtimet tregojnë se mangësitë në komunikimin verbal mund të ndikojnë në aftësinë e fëmijës për të ndërvepruar verbalisht me të tjerët, llojet e sjelljeve që shfaq fëmija, si dhe përgjigjet që fëmija nxjerr nga të tjerët (Conde, 2006).

Edukatorët kanë një rol të rëndësishëm në modelimin e komunikimit verbal, gjatë këtyre viteve kritike, kur është më se e nevojshme dhe e domosdoshme për fëmijët. Lidhur me këtë, Presence (2017) paraqet disa strategji që duhet të përdoren nga edukatorja për të nxitur komunikimin verbal te fëmijët, si:

- Të flasim me ta, duke u bërë pyetje fëmijëve në lidhje me interesat e tyre ose aktivitetet e përditshme për të filluar një bisedë: Ashtu si aftësitë e tjera, gjuha është një aftësi e praktikuar;
- Të bëhen dëgjues të mirë duke mos harruar të jenë dëgjues aktivë: Shprehjet e fytyrës, kontakti me sy dhe afërsia do të përcjellin interesin tuaj për atë që thotë fëmija, gjë që do ta inkurajojë atë të vazhdojë të flasë;
- Të ndihmohen të mësojnë fjalë të reja: Një fjalor më i madh i ndihmon fëmijët të komunikojnë më shumë, por gjithashtu i ndihmon ata të kuptojnë më mirë atë që dëgjojnë;
- Të lexojnë libra së bashku, të mësojnë këngë dhe vjersha;
- Të praktikojnë shkronja duke theksuar tingujt.
- Të dinë kur të kërkojnë mbështetje shtesë.

Këto janë disa nga strategjitë, por hulumtimi paraqet edhe të tjera strategji, të cilat janë të paraqitura edhe në literaturë si strategji që pasqyrojnë rolin e edukatores në zhvillimin më të mirë të komunikimit verbal te fëmijët

**1.3. Strategjitë e edukatores, të cilat mbështesin komunikimin verbal të fëmijëve (3-6 vjeç) me vështirësi në të folur**

Në literaturë hasim disa strategji që duhet t'i përdorë edukatorja për të zhvilluar komunikimin verbal me të gjithë fëmijët në institucione parashkollore, siç janë: Përfshirja e të gjithë fëmijëve në bashkëbisedim; mbajtja e kontaktit me sy; Dhënia e udhëzimeve të qarta për fëmijët; Reagimet kur është e nevojshme; Vendosja e pritshmërive të të mësuarit dhe të zhvillimit; Bashkëpunimi me prindërit e fëmijës, si dhe me profesionistët që e mbështesin fëmijën (p.sh. patologun e të folurit), për të vendosur qëllime specifike dhe të matshme; Vëmendja e plotë për fëmijën; Përdorimi i të folurit më të ngadaltë; Durimi; Zbatimi i përvojave që sjellin rezultate; Inkurajimi i bashkëbisedimit edukatore-fëmijë dhe fëmijë-fëmijë etj.

Edukatorja, gjatë punës me fëmijët e një grupi, duhet të përdorë strategji të përshtatshme, pavarësisht se fëmijët kanë moshë afërsisht të njëjtë dhe nuk i kanë aftësitë, shkathtësitë dhe zhvillimin e njëjtë. Kjo gjendje e vë edukatoren në një situatë që të përdorë strategji, mjete dhe materiale të përshtatshme për të gjithë fëmijët e grupit, duke përfshirë edhe fëmijët me vështirësi në komunikim verbal. Se çfarë mund të bëjë një edukatore kur në klasë ka fëmijë që kanë vështirësi në marrjen udhëzimeve (informatave) dhe në zhvillim të komunikimit verbal, tregon NHSAA (2016), sipas së cilës roli i edukatores është që ajo të sigurohet që e ka vëmendjen e fëmijës kur është duke folur: të lavdërojë ata kur e bëjnë këtë; të japë udhëzime përpara një aktiviteti jo gjatë aktivitetit; të nxisë fëmijën t'i përsërisë udhëzimet dhe të sigurohet që fëmijët e kanë dëgjuar. Disa fëmijë e kanë të vështirë të pranojnë dhe mbajnë mend sasi të mëdha të informacionit, prandaj edukatorja flet ngadalë dhe bën pauzë midis frazave; përdor fjali të shkurtra e të thjeshta; thekson fjalët kyçe kur jep informacion; ngadalëson ritmin e të folurit (NHS Ayshire & Arran, 2016). Gjithnjë sipas NHSAA, hulumtimet tregojnë se këto strategji janë shumë efektive për fëmijët me vështirësi në të kuptuar dhe në të folur: Përdorimi i



pamjeve të qarta ose fotografive gjatë dhënies së informacionit; Disa fëmijë kanë nevojë për kohë shtesë për të përpunuar informacionin, prandaj duhet pritur nëse fëmija nuk përgjigjet menjëherë; Lavdëroni fëmijët që kërkojnë ndihmë kur është e nevojshme; Nëse një fëmijë nuk e ka kuptuar, provoni ta përsërisni atë që keni thënë në vend që të riformuloni.

Rifrazimi mund të rrisë ngarkesën e gjuhës për fëmijën me vështirësi, prandaj nxiten fëmijët të ritregojnë çfarë ndodhi në një histori për të kontrolluar të kuptuarit e tyre etj. (NHS Ayshire & Arran, 2016).

Sipas Virtual Lab School (2021), janë disa strategji që edukatorët mund t'i përdorin për të nxitur komunikimin verbal me fëmijët që kanë vështirësi në të folur:

- Të jenë model: Kur një fëmijë komunikon joverbalisht, ndihmoni dhe thoni atë që do të kishte thënë ai.
- Zgjeroni fjalorin: Nëse fëmija nxjerr një tingull ose thotë një ose disa fjalë, zgjerojini ato në fraza ose fjali më të gjata, pak më të ndërlikuar se ato që thotë fëmija.
- Përshkruani me fjalë ato që bëjnë fëmijët: Ndërsa fëmijët janë të përfshirë në përvoja, flisni dhe përshkruajeni atë që po bëjnë.
- Bëni pyetje: Përdorni pyetje të hapura, që lidhen me përvojat e fëmijëve.
- Dëgjoni përpara se të përgjigjeni: Pasi të bëni një pyetje ose një koment, prisni që një fëmijë të komunikojë, të dëgjoni atë që ata kanë për të thënë dhe më pas përgjigjuni (Virtual Lab School, 2021).

Janë këto dhe disa strategji të tjera, të cilat janë përfshirë në hulumtim dhe rezultatet na japin pasqyrën e gjendjes,

se cilat strategji i përdorin edukatorët tona për të zhvilluar komunikimin verbal të fëmijët me vështirësi në të folur.

- Loja mund të përdoret si strategji nga edukatorja për të zhvilluar komunikimin verbal të fëmijëve në institucion parashkollor.

Të mësuarit përmes lojës është strategji që ndihmon fëmijët të zhvillohen në të gjitha fushat e zhvillimit të tij, e gjithësi edhe në zhvillimin e komunikimit verbal. Sipas UNICEF 2022, fëmijët luajnë sepse loja është argëtuese. Loja është çelësi i mësimit dhe zhvillimit të tyre. Loja, e strukturuar dhe e pastrukturuar, hedh themelet për zhvillimin e të mësuarit dhe aftësive jetësore të fëmijës në të ardhmen, si dhe zhvillon aftësitë e gjuhës dhe komunikimit: të menduarit, planifikimit, organizimit dhe vendimmarrjes (UNICEF, 2022).

Fëmijët parashkollorë e konceptojnë botën në mënyrë më të natyrshme përmes lojës. Loja e fëmijëve motivon shprehjen e mendimeve dhe ndjenjave - mendimin divergjent, zhvillon aftësitë gjuhësore, krijon vetëdije për potencialin e gjuhës (për shembull, fëmijët kuptojnë se mund të përdorin gjuhën për të shprehur mendimin e tyre, për të kuptuar të tjerët, për të shprehur dhembshuri) (Sego, 2009). Loja e fëmijës jep kënaqësi, mundëson komunikimin dhe socializimin, ndërveprimin me të rriturit dhe bashkëmoshatarët. Gjatë lojës, fëmijët mund ta çlirojnë veten nga përvojat negative.

Përveç kësaj, edukatorët dhe bashkëmoshatarët kanë një rol të rëndësishëm si partnerë komunikimi për fëmijët e vegjël në fëmijërinë e hershme në kopshte. Sipas The education hub (2019), "hulumtimet tregojnë se sasia dhe cilësia e ndërveprimeve të edukatorëve është kritike në mbështetjen e fëmijëve të vegjël për të mësuar. Fëmijët mësojnë nga ajo që thonë të rriturit dhe nga mënyra se si të rriturit reagojnë ndaj përpjekjeve të tyre komunikuese.

Ndërveprimet e përgjegjshme ndërmjet të rriturve dhe fëmijëve mund të zgjerojnë gjuhën e fëmijëve dhe të modelojnë komunikim efektiv në situata sociale” (The Education Hub, 2019).

**1.4. Mjedisi, mjetet dhe materialet që përdor edukatorja për të nxitur komunikimin verbal te fëmijët me vështirësi në të folur**

Mjedisi, në të cilin edukatorja realizon aktivitetet me fëmijë, ka shumë rëndësi në zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve. Profesionistët porosisin se, derisa aftësitë e komunikimit zhvillohen, prindërit dhe edukatorët duhet të sigurohen që po ofrojnë një mjedis të pasur me gjuhë... kjo është gjithashtu koha për të monitoruar nga afër zhvillimin e gjuhës për të kapur herët vonesat e të folurit dhe komunikimit (Marshall-Seslar, 2022).

Lidhur me ndikimin e të rriturve dhe mjedisit në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët, ICOMMUNICATE (2013) tregon se aftësitë e të folurit dhe të gjuhës nuk evoluojnë vetë. Ato janë pjesë e një tabloje më të madhe, e cila përfshin: ndërveprimin social, lojën, vëzhgimin, manipulimin e objekteve, dëgjimin dhe pjesëmarrjen. Të gjithë këta faktorë punojnë së bashku dhe shpesh pa njërin është e vështirë të zhvillohet një tjetër (ICCOMMUNICATE, 2013). Sipas Segos (2009), në një mjedis intelektualisht stimulues dhe emocionalisht të shëndetshëm, në një atmosferë dashurie të mbushur me mirëkuptim, një fëmijë do të zhvillojë me sukses potencialet e tij/saj (Sego, 2009). Ndërsa, ESSAYS (2020) thekson se zhvillimi i gjuhës dhe i aftësive sociale ndikojnë shumë në aftësinë e një fëmije për të komunikuar. Këto aftësi zhvillohen me një ritëm të ndryshëm për çdo person dhe kjo varet shumë nga mjedisi ku ai ekspozohet, njerëzit nga të cilët janë të rrethuar dhe niveli i ndërveprimit ndaj të cilit ekspozohet një fëmijë (ESSAYS, 2020).

Cohen (2012) shprehet se "zhvillimi kognitiv në një moshë të hershme është thelbësor për aftësinë e një fëmije për të qenë në gjendje të shfrytëzojë, të mësojë dhe të përshtatet

me mjedisin e tij rrethues" (Cohen, 2012). Sipas tij, pa u stimuluar mjaftueshëm fëmija nuk i ka mundësitë e duhura të mësojë dhe të zhvillojë gjuhën.

Light & Drager (2012) porosisin edukatorët të rregullojnë mjedisin për të mbështetur komunikimin te fëmijët. Kur e rregulloni mjedisin, poziciononi fëmijët tuaj që të maksimalizojnë shikimin, dëgjimin dhe aftësitë motorike dhe pozicionoheni veten për të maksimizuar ndërveprimin në mënyrë të përshtatshme (Light, & Drager, 2012). Fëmija do të jetë në gjendje të marrë pjesë në mënyrë efektive në ndërveprimet sociale nëse mund të shohë, të dëgjojë, të arrijë dhe të prekë sendet e lidhura (për shembull, simbolet e figurës, lodrën etj.), në masën më të madhe të mundshme.

Sipas Marshal-Seslar, librat me ilustrime janë më të mirët për zhvillimin e hershëm të gjuhës, sepse janë të sigurt për t'u eksploruar për fëmijën. Edukatorët mund të përshkruajnë ilustrime dhe t'i lidhin historitë me jetën reale të fëmijës (Marshall-Seslar, 2022).

Librat janë një mënyrë e shkëlqyer për të punuar me shumë aftësi dhe fëmijët i duan ata. Shikoni librat së bashku, emërtoni figurat, bëni pyetje dhe flisni për historinë! Edhe muzika është, gjithashtu, një mënyrë e shkëlqyer për të përfshirë fëmijën dhe mund të përdoret në shumë mënyra për të përmirësuar të folurit... disa këngë mund të këndohen duke përfshirë veprime dhe duke krijuar lidhjen midis fjalëve dhe veprimeve (ICCOMMUNICATE, 2013).

## 1.5. Qëllimi dhe pyetjet e hulumtimit

- 1.5.1. Qëllimi i hulumtimit** Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të analizojë rolin e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, të cilët kanë vështirësi në të folur. Hulumtimi, gjithashtu, identifikon strategjitë që përdorin edukatorët për

të ndikuar në zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve me vështirësi në të folur, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit edukatore-prind, në funksion të qasjes së duhur ndaj fëmijëve me vështirësi në të folur

### 1.5.2. Pyetjet e hulumtimit

Pyetja themelore e hulumtimit është:

- Cili është roli i edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët parashkollorë me vështirësi në të folur?

Hulumtimi është mbështetur edhe në pyetjet ndihmëse, të cilat janë:

- Cilat strategji i përdor edukatorja për të ndikuar në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët që kanë vështirësi në të folur?
- Si përdoren mjedisi dhe materialet edukative nga ana e edukatores gjatë komunikimit verbal me fëmijët që kanë vështirësi në të folur?
- Si e shohin prindërit rolin e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve të tyre me vështirësi në të folur?
- Cilat janë mënyrat e bashkëpunimit të edukatores me prindërit lidhur me zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve parashkollorë me vështirësi në të folur?

### 1.6. Metodologjia

Është përdorur qasja cilësore për grumbullimin e të dhënave, përmes të cilave kemi nxjerrë në pah rolin e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët 3-6 vjeç, të cilët kanë vështirësi në të folur, duke vëzhguar aktivitetet e edukatores në klasë; duke i dhënë mundësinë e vetëreflektimit për aktivitetin e realizuar, pas përfundimit të vëzhgimit, dhe duke intervistuar me intervistë gjysmë të strukturuar. Për bashkëpunimin edukator-prind, të dhënat

janë mbledhur me intervistë gjysmë të strukturuar, me edukatore dhe me prindër

**Mostra** Mostra është e qëllimshme. Respondentë në hulumtim janë 34 edukatore, në 22 kopshte (17 në 11 kopshte publike dhe 17 në 11 kopshte private). Janë përfshirë në hulumtim 34 fëmijë me vështirësi në të folur, nga të cilët 15, përveç vështirësisë në të folur, janë fëmijë me nevoja të veçanta. Për pjesën e bashkëpunimit me prindër janë intervistuar 22 respondentë (12 edukatore dhe 10 prindër, të fëmijëve me vështirësi në të folur).

**Instrumentet** Për realizim të këtij hulumtimi, janë përdorur instrumentet e vëzhgimit për edukatore dhe intervistë gjysmë e strukturuar. Instrumenti i vëzhgimit përmban makrokritere dhe brenda secilës ka mikrokritere, që janë plotësuar gjatë vëzhgimit. Kërkesat që nuk mund të vëzhgoheshin direkt u realizuan përmes intervistës gjysmë të strukturuar. Për bashkëpunimin edukatore-prind, po ashtu, u realizua intervistë gjysmë e strukturuar.

Makrokriteret në instrumentin e vëzhgimit ishin:

- Të dhënat përshkruese;
- Roli i edukatores dhe strategjitë që përdor edukatorja për të nxitur komunikimin verbal me të gjithë fëmijët e grupit;
- Strategjitë e edukatores për të nxitur komunikimin të fëmijët me vështirësi në të folur;
- Mjedisi, mjetet dhe materialet që përdor edukatorja për të nxitur komunikimin me fëmijët që nuk flasin.

Duke realizuar vëzhgimin, doli e nevojshme që të përfshihet edhe një mikrokriter, për të marrë të dhëna edhe për nevojat e edukatores për zhvillim profesional lidhur me temën e hulumtimit.

Vëzhgimi është realizuar gjatë kohës kur edukatorja e mban takimin e përbashkët me fëmijët dhe aktivitetet në grupe të vogla. Pyetjet e intervistave të edukatoreve dhe prindërve ishin rreth 4 makrokritereve të shënuara më lart.

#### **Procedurat e mbledhjes së të dhënave**

Janë hartuar instrumentet, të cilat fillimisht janë pilotuar në një kopsht publik dhe në një kopsht privat, për të vazhduar me plotësimet e nevojshme në instrumentet e hulumtimit.

Pas përgatitjes së instrumenteve hulumtuese, janë njoftuar drejtoreshat e institucioneve publike dhe private për qëllimin e hulumtimit dhe për të marrë informata se a mund të realizojmë hulumtimin me një mostër që e kemi për qëllim të hulumtojmë. Përmes drejtoreshave, i kemi siguruar edhe kontaktet e prindërve që i intervistuar.

Intervistat me prindër dhe edukatore janë zhvilluar në një kohë dhe vend të përshtatshëm për pjesëmarrësit, kryesisht në mjediset e institucioneve parashkollore. Të gjithë prindërit dhe edukatorët, pas informimit me shkrim dhe sqarimit se intervistimi dhe mbledhja e të dhënave është proces konfidencial, dhanë pëlqimin që të jenë pjesëmarrës anonimë në intervistë.

Për realizim të hulumtimit në kopshtet private, është njoftuar Divizioni për Arsim Privat në MASHTI dhe të gjitha institucionet parashkollore e kanë mirëpritur realizimin e hulumtimit.

#### **Analiza dhe interpretimi**

Të dhënat e mbledhura janë grupuar në kategori tematike (përvojat e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve, strategjitë, përdorimi i mjedisit, bashkëpunimi me familjen etj.), të cilat lidhen me pyetjet kërkimore.

Të gjitha të dhënat që janë mbledhur janë vendosur në programin Google Forms dhe një pjesë e të dhënave të

përgjithshme janë përpunuar me program, ndërsa pjesa e intervistës me edukatoren (para vëzhgimit në klasë) dhe pjesa tjetër e analizës tematike të të dhënave të vëzhgimit në klasë, që janë përpunuar me analizën tematike, janë bartur në tabela, në programin Word, duke i kategorizuar sipas makrokritereve dhe mikrokritereve, për të cilat pastaj është bërë interpretimi dhe përshkrimi brenda një strukture të temave që e karakterizojnë këtë hulumtim<sup>1</sup>.

**1.7. Rezultatet e hulumtimit** paraqesin gjendjen faktike në terren, përfaqësojnë mostrën e përzgjedhur dhe nuk i përgjithësojnë rastet në nivel vendi.

**1.7.1. Të dhënat e përgjithshme** Në hulumtim janë përfshirë 22 institucione parashkollore (11 institucione parashkollore publike dhe 11 institucione parashkollore private), në 9 komuna të Kosovës

---

<sup>1</sup> Në kapitullin I, pjesa e të dhënave të përgjithshme, që përfshijnë intervistën me edukatoren, si dhe pjesa e analizës tematike të të dhënave, janë analizuar në formë tabelare dhe pastaj janë përmbledhur gjetjet në formë përshkuese për secilin makro dhe mikrokriter. Te nëntitulli **Roli i edukatores dhe strategjitë që përdorë në zhvillimin e komunikimit verbal me të gjithë fëmijët në grup** është paraqitur një model i tabelës, se si janë përpunuar të gjitha të dhënat, por për arsye që të mos vendosen tabela në secilin makro e mikrokriter, gjetjet janë vendosur në formë përshkuese, në gjithë kapitullin.





Fig. 1. Numri i edukatoreve të përfshira në hulumtim sipas komunave


Përzgjedhja e komunave është bërë në mënyrë të rastësishme, përveç komunës së Prizrenit, përzgjedhja e së cilës ishte e qëllimshme dhe arsyeja ishte se komuniteti i Prizrenit flet më shumë gjuhë. Duke qenë se në hulumtim është trajtuar vështirësia në komunikim verbal, është bërë një përfshirje më e madhe e mostrës në institucionet publike dhe private të kësaj komune.

Ndërsa, përzgjedhja e mostrës së institucioneve parashkollore, publike dhe private, ishte e qëllimshme, sepse kusht për realizim të hulumtimit me edukatorët ishte që në grup të kishte fëmijë që kanë vështirësi në të folur.

Të gjitha institucionet private, të përfshira në hulumtim, janë institucione të licencuara në MASHTI (MASHTI, 2022).

- **Numri i edukatoreve të përfshira në hulumtim**

Është realizuar përzgjedhje e qëllimshme për edukatorët që janë vëzhguar, me qëllim që në klasat ku është realizuar hulumtimi të ketë fëmijë që u përkasin vështirësive në komunikimin verbal.



*Fig. 2. Numri i edukatoreve të përfshira në hulumtim sipas Institucioni parashkollor publik dhe privat*

Në hulumtim janë përfshirë gjithsej 34 edukatore të institucioneve parashkollore që punojnë me grupmoshat 3-6 vjeç, 17 edukatore që punojnë në institucione parashkollore private dhe 17 edukatore që punojnë në institucione parashkollore publike. Këto edukatore, në grupin e fëmijëve i kanë përfshirë 34 fëmijë që flasin ndonjë fjalë, fëmijë që nuk flasin, por kuptojnë, fëmijë që nuk flasin as nuk kuptojnë dhe, si pasojë e kësaj, kanë vështirësi në komunikim me edukatoren dhe me fëmijët e tjerë.

Për të kuptuar se si qëndron gjendja me fëmijët, për të cilët është vëzhguar edukatorja, paraprakisht janë realizuar disa pyetje me edukatoren, si:

- A hartojnë plan individual për këta fëmijë?
- Cilat karakteristika i kanë fëmijët me vështirësi në komunikimin verbal?
- A janë vlerësuar nga profesionistët?
- Në rast se janë vlerësuar, nga kush janë vlerësuar?
- Në rast se nuk janë vlerësuar, pse nuk janë vlerësuar etj.?

- A kanë mbështetje shtesë apo asistente për këta fëmijë?
- Nëse kanë mbështetje, kush e ofron atë mbështetje?
- Nëse nuk kanë, pse nuk kanë mbështetje shtesë ose asistencë edukatore, në punë me këta fëmijë?

Të dhënat nga pyetjet me edukatoren janë paraqitur të përmbledhura dhe rezultatet e përgjigjeve janë si më poshtë:


**- Plani individual për fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal**

Në këtë hulumtim, që trajton rolin e edukatores me fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal, patjetër që është trajtuar edhe aspekti i fëmijëve që kanë vështirësi në komunikimin verbal dhe janë me nevoja të veçanta, prandaj ishte e domosdoshme të trajtohet planifikimi i punës me këta fëmijë.

Në hulumtime të ndryshme shkencore, raporte dhe dokumente, ka pajtueshmëri që edukatorët kanë rol të rëndësishëm në mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, në zhvillim të komunikimit të tyre në ambiente të klasës. Shumë studiues kanë theksuar se edukatorët e fëmijëve parashkollorë, me nevoja të veçanta, duhet të punojnë në zhvillimin e aftësive komunikuese të fëmijëve gjatë aktiviteteve të përditshme në klasë (Roberts et, al., 1991).

Sipas Brebner et. al (2016), në studimin e realizuar me edukatorët e edukimit të hershëm, përmendet pajtueshmëria e të gjitha edukatoreve të përfshira në studim dhe për të zhvilluar një marrëdhënie ose 'lidhje' me një fëmijë dhe/ose familjen e tij komunikimi efektiv, verbal dhe joverbal, është thelbësor dhe anasjelltas (Brebner et, al., 2016).

Rezultatet e këtij hulumtimi janë bazuar në atë se edukatorët janë vëzhguar për punën me fëmijët që kanë vështirësi në komunikim verbal, pavarësisht a janë fëmijë pa ndonjë diagnozë, a janë fëmijë me nevoja të veçanta. Ishte e nevojshme të vihet në pah se a përdorin edukatorët plan individual për këta fëmijë dhe rezultatet tregojnë se:



*Fig. 3. Zbatimi i planit individual për fëmijët me vështirësi në komunikim verbal*


Vetëm dy edukatore kanë hartuar Plan Individual të Arsimit - PIA për fëmijët që kanë vështirësi në komunikim verbal dhe nuk është bërë vlerësim nga ekipi profesional i komunës, por nga vetë nevojat që i kanë parë për të mbështetur fëmijën, kanë hartuar plan të tillë edukatorët dhe drejtoreshat. Përndryshe, bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 18/2013, përdorimi i Planit Individual të Arsimit, neni 3, pika 1, për të hartuar edukatorja një plan individual „të drejtën për PIA e kanë të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, me vendimin për arsim me nevoja të veçanta, nga ekipi vlerësues dhe mbështetës i komunës” (MASHT, 2013).

Edukatorët që nuk kanë hartuar PIA, për fëmijët që kanë vështirësi në komunikim verbal, tregojnë se një nga arsytet

pse nuk është hartuar një plan i tillë është pikërisht ky nen i udhëzimit administrativ, pasi nuk u është bërë fëmijëve ndonjë vlerësim nga Ekipi Vlerësues dhe Mbështetës i Komunës, si dhe shumë prindër nuk e vlerësojnë që fëmija i tyre ka nevojë për një plan individual.


**- Karakteristikat e fëmijëve që kanë vështirësi në të folur**

Fëmijët, për të cilat është vëzhguar edukatorja, i kanë këto karakteristika: flasin vetëm ndonjë fjalë – 20 fëmijë; nuk flasin, por kuptojnë – 9 fëmijë dhe nuk flasin as nuk kuptojnë – 5 fëmijë. Po ashtu, në grupe ka edhe fëmijë dygjuhësh, që sipas edukatoreve ose flasin vetëm gjuhë të huaj, ose flasin fare pak gjuhë amtare dhe njëkohësisht edhe një ose dy gjuhë të huaja. Kjo e vështirëson më shumë punën e edukatoreve me këta fëmijë, sepse edukatorët nuk e njohin gjuhën angleze ose gjuhën tjetër të huaj dhe pastaj as nuk kuptohen ndërmjet vete.



*Fig. 4. Karakteristikat e fëmijëve me vështirësi në komunikim verbal të përfshirë në hulumtim*


- **Vlerësimi profesional për fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal** Fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal dhe trajtohen me kohë nga profesionistët adekuatë bëjnë që pasojat të jenë më të vogla në zhvillimin e fëmijës. Lidhur me këtë, Presence (2017) shkruan se fëmijët zhvillohen me ritme të ndryshme, kështu që ata mund të jenë të aftë në disa aftësi, ndërsa të tjerat u mungojnë. Një profesionist (logoped) mund të kryejë vlerësime për të përcaktuar nëse fëmija ka një mangësi të aftësive ose një paaftësi gjuhësore të diagnostikuar (Presence, 2017). Bashkëpunimi ndërmjet prindërve, kopshtit dhe edukatores, lidhur me vlerësimin profesional të fëmijëve që kanë vështirësi në komunikim, mund të ndihmojë fëmijët në zhvillimin e komunikimit verbal.



*Fig. 5. Numri i fëmijëve që janë vlerësuar dhe nuk janë vlerësuar nga profesionistët*

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 18/2013, ekipet profesionale komunale e realizojnë vlerësimin për fëmijët nëse kanë nevojë për ndonjë vlerësim nga profesionistët ose jo dhe gjithnjë duke u pajtuar dhe duke qenë pjesëmarrës edhe prindërit në një vlerësim të tillë. Siç tregojnë rezultatet, ekipet profesionale të arsimit në

komuna nuk janë të angazhuara në asnjë nga rastet e hulumtuara, nuk kishte vlerësim nga ekipi komunal për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, andaj edhe kemi vlerësimet si më poshtë:



*Fig. 6. Numri i rasteve sipas vlerësimit të profesionistëve*

Rezultatet tregojnë se 34 rastet e përfshira në hulumtim janë vetëm 18 raste që u është bërë një vlerësim profesional fëmijëve që kanë vështirësi në komunikim. Nga këto raste, në të cilat është bërë vlerësimi profesional, prindërit sjellin dëshmi se është bërë vlerësim për fëmijët e tyre që kanë vështirësi në të folur (nga logopedi, psikologu etj.) dhe komunikojnë me edukatorët për të mbështetur fëmijën me këshillat që marrin nga profesionistët.

Janë gati gjysma e rasteve (16 fëmijë) që nuk u është bërë asnjë vlerësim profesional për fëmijët që kanë vështirësi në komunikim verbal dhe edukatorja nuk merr ndonjë

mbështetje nga profesionistët jashtë institucionit parashkollor.


- **Arsyet pse nuk është bërë vlerësim profesional** Arsyet që japin prindërit pse nuk e kanë bërë ndonjë vlerësim te profesionistët për fëmijët e tyre. Sipas edukatoreve, në raste të rralla, prindërit ndoshta edhe bashkëpunojnë me profesionistë, por nuk sjellin asnjë dëshmi në institucion dhe as ndonjë sugjerim apo propozim për t'u mbështetur fëmijët nga edukatorja.

Në të shumtën e rasteve, për fëmijët që nuk janë vlerësuar nga profesionistët arsyeja është se prindërit nuk e pranojnë që fëmijët e tyre kanë nevojë për t'i dërguar te profesionistët (logopedi, psikologu, psikiatri etj). Edukatorët dhe drejtoreshat kanë ofruar dëshmi për kërkesat që ua kanë bërë prindërve që të bëjnë vlerësimin profesional dhe, bazuar në atë vlerësim, t'u kushtojnë më shumë rëndësi fëmijëve përkatës, por nuk kanë marrë miratimin e prindërve me arsyetimin se fëmijët e tyre nuk kanë nevojë për profesionistë. Ka raste kur nuk e pranojnë që fëmijët e tyre nuk flasin në kopsht, sepse në shtëpi flasin mirë, por as për këtë nuk kanë sjellë ndonjë raport vlerësimi, pse fëmija flet në shtëpi e nuk flet në kopsht.

- **Mbështetja brenda institucionit për edukatoren** Mbështetja shtesë për edukatoren është shumë e nevojshme kur në grup ka fëmijë që kanë nevojë për më shumë mbështetje, sidomos për fëmijët me nevoja të veçanta. Fëmijët me nevoja të veçanta kanë filluar të përfshihen në edukimin parashkollor vitet e fundit. Kjo falë ligjeve dhe udhëzimeve administrative dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë për nevojën dhe përfitimet e kësaj përfshirjeje. Sfidat e përfshirjes së këtyre fëmijëve në institucione janë të mëdha, për arsye se nuk ka numër të mjaftueshëm të edukatoreve mbështetëse dhe asistentëve. Në anën tjetër, edukatorët mund të




ballafaqohen me vështirësi në realizimin e punës së tyre, si mungesës së trajnimeve për punë me fëmijë me nevoja të veçanta, numrit të madh të fëmijëve në grup etj. Sipas Presence (2017), edukatorët duhet të dinë kur të kërkojnë mbështetje shtesë nëse një fëmijë nuk po i merr aftësitë e komunikimit verbal, i mungon interesi për ushtrimet e fjalorit ose ka probleme dhe, sipas udhëzimeve, kjo mund të jetë koha për t'u konsultuar profesionistët (Presence, 2017).



*Fig. 7. Numri i edukatoreve që marrin mbështetje shtesë në punën e tyre për fëmijët me vështirësi në komunikim verbal*

Sa i përket mbështetjes brenda institucionit për edukatoren që ka fëmijë me vështirësi në komunikim, kemi këto rezultate: në 27 raste edukatorët nuk marrin fare mbështetje shtesë për fëmijën me vështirësi në komunikim, ndërsa në 7 raste edukatorët marrin mbështetje për fëmijët me vështirësi në komunikimin verbal. Rastet që kanë mbështetje shtesë brenda institucionit parashkollor janë kryesisht rastet e fëmijëve

që prindërit e tyre e pranojnë që fëmijët e tyre kanë nevojë për mbështetje shtesë, të cilët janë fëmijë me nevoja të veçanta.



*Fig. 8. Cila mbështetje shtesë (përveç edukatores) u ofrohet fëmijëve*

Te 7 rastet që edukatoret kanë mbështetje shtesë për fëmijët me vështirësi në komunikim verbal, 3 nga këto raste kanë asistente të angazhuar nga prindi dhe psikologu i kopshtit, në dy raste ka asistente të punësuar nga kopshti dhe 2 raste të tjera kanë vetëm asistenten e punësuar nga prindi i fëmijës. Këtu duhet theksuar fakti se, në grupet ku ka asistente të angazhuar, është vërejtur që nuk ka koordinim të mjaftueshëm ndërmjet edukatores dhe asistentes, duke marrë parasysh se gjithë përgjegjësia e punës binte tek asistentja, gjë që nuk duhej të ndodhte. Koordinimi edukatore-asistente është shumë i nevojshëm për fëmijët.

- **Arsyeja e mungesës së mbështetjes shtesë për** Sipas edukatoreve, në të shumtën e rasteve, arsyeja e mungesës së mbështetjes shtesë, gjatë qëndrimit në kopsht, për fëmijët me vështirësi në komunikim, është se prindi nuk e pranon që fëmija i tij ka nevojë për mbështetje

### **fëmijët me vështirësi në të folur**

shtesë. Sipas edukatoreve, në rastet kur fëmijët nuk flasin, prindërit shpesh arsyetohen: e kanë trashëguar nga paraardhësit vonesën në të folur dhe se do të flasin më vonë; se fëmija në shtëpi flet mirë, por që në kopsht nuk flet; fëmija flet në gjuhë angleze dhe nuk e shohin problem pse nuk flet në gjuhën shqipe, edhe pse shumë herë nuk kuptohen me edukatoren.

Në disa raste prindërit e kanë vullnetin për të angazhuar asistente shtesë për fëmijët me vështirësi në të folur, por nuk kanë kushte financiare të mbulojnë shpenzimet vetë dhe kanë bërë kërkesa në DKA, për të angazhuar asistent, por nuk janë aprovuar.

Në një numër të vogël të kopshteve ka edukatore mbështetëse, e cila duhet të merret me të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta që ka kopshti dhe kjo nuk është e mjaftueshme për fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal.

Për një numër të vogël të fëmijëve me vështirësi në komunikim, arsyeja pse nuk kanë mbështetje shtesë është se kopshti dhe edukatorja nuk e kanë parë të nevojshme angazhimin e mbështetjes shtesë, sepse me punën e edukatores fëmijët po përparojnë shumë mirë dhe e kanë përmirësuar gradualisht komunikimin verbal.

### **1.7.2. Analiza tematike e hulumtimit – roli i edukatores, strategjitë dhe mjedisi**

Bazuar në analizën e literaturës dhe në kontekstin e punës në institucionet parashkollore të ne, në hulumtim janë përfshirë disa strategji që mund të nxisin dhe zhvillojnë komunikimin verbal të fëmijët në institucione parashkollore, si: roli që ka edukatorja në zhvillimin e komunikimit verbal me fëmijët; strategjitë që zbaton edukatorja me të gjithë fëmijët e grupit; strategjitë që përdor edukatorja me fëmijët që kanë vështirësi në komunikim verbal, si dhe metodat e bashkëpunimit që

përdor edukatorja me prindërit për të zhvilluar komunikimin verbal te fëmijët

**1.7.2.1. Roli i edukatores dhe strategjitë që përdor në zhvillimin e komunikimit verbal me të gjithë fëmijët në grup**

Hulumtimi kishte për qëllim të analizojë rolin i edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal me fëmijët që kanë vështirësi në të folur, por njëkohësisht u mblodhën të dhëna edhe për komunikimin e edukatores me fëmijët e tjerë të grupit, sepse kjo vihej në dukje shumë gjatë vëzhgimit. Prandaj, një pjesë e rezultateve janë për rolin e edukatores dhe strategjitë në zhvillimin e komunikimit të të gjithë fëmijëve të grupit, pastaj pjesa tjetër e rezultateve është specifike, për rolin e edukatores dhe strategjitë në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët me vështirësi në të folur.

Tabela e mëposhtme prezanton rezultatet e nënkriterit 1.1: *Përfshirja e të gjithë fëmijëve në bashkëbisedim*, dhe është pjesë e kriterit *Strategjitë që përdor edukatorja për të nxitur komunikimin verbal me fëmijët e gjithë grupit*. Në një format të tillë, janë përpunuar të gjitha të dhënat cilësore të këtij hulumtimi, por, meqenëse ka shumë tabela, për secilin nënkriter nga një, në rastet e tjera nuk janë paraqitur tabelat, vetëm interpretimi përfundimtar i secilit nënkriter, në formë përshkruese

*Tabela.1. Roli i edukatores dhe startegjitë që përdorë në zhvillimin e komunikimit verbal me të gjithë fëmijët në grup*

<p>1. Strategjitë që përdor edukatorja për të nxitur komunikimin verbal me të gjithë fëmijët e grupit</p>	<p>1.1. Përfshirja e të gjithë fëmijëve në bashkëbisedim</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesërisht jo të gjithë;</li> <li>- Përfshihen kënaqshëm, me theks kur humb vëmendja i thërret emrin;</li> <li>- Jo të gjithë;</li> <li>- Pjesërisht, vetëm ata që komunikonin;</li> <li>- Pjesërisht, vetëm ata që janë më aktivë;</li> <li>- Po, vetëm një fëmijë hezitonte;</li> <li>- Bën pyetje që nxit komunikimin;</li> <li>- Po, me anë të pyetjeve dhe përgjigjeve;</li> <li>- Po, brenda aktivitetit;</li> <li>- Po, kohë pas kohe, por një fëmijë e tejkalon pasi që e di që nuk flet dhe nuk insiston;</li> <li>- Jo të gjithë;</li> </ul>	<p>Sa u përket strategjive që përdor edukatorja me të gjithë fëmijët e grupit për të nxitur komunikim verbal, te përfshirja e fëmijëve në bashkëbisedim rezultatet paraqesin se në të shumtën e rasteve edukatorja përfshin të gjithë fëmijët në bashkëbisedim. Pavarësisht se ndonjëherë ndonjë fëmijë hezitonte të bashkëbisedonte, edukatoret përdornin teknikën e bashkëbisedimit me radhë dhe kjo tregonte se fëmijëve kur u ka ardhur radha e kanë shprehur mendimin e tyre lidhur me bashkëbisedimin që ka ndodhur.</p> <p>Ka raste që edukatorja pjesërisht i përfshin fëmijët në bashkëbisedim, duke u dhënë</p>
---	--	---	---

- Në takim të përbashkët kur u vjen radha;
- Po, shumë e kënaqshme;
- Po, në komentim të përrallës;
- Një fëmijë nuk inkuadrohet në bashkëbisedim, largohet në një qoshe të klasës, është me asistente;
- Po, në aktivitete bashkëbisedimi;
- Po, por pa ndonjë insistim për një fëmijë që nuk flet;
- Jo të gjithë, një fëmijë nuk përfshihet;
- Po, shumë i mirë;
- Po, të gjithë sistematikisht;
- Janë të përfshirë të gjithë, por edukatorja veçon shumë një fëmijë që ka vështirësi në komunikim;

mundësinë vetëm atyre që komunikojnë më shumë, pa i nxitur të tjerët.

Në disa raste edukatorët nuk i përfshijnë fare fëmijët që kanë vështirësi në komunikim, duke i lënë jashtë aktivitetit dhe pa u përfshirë fare as në aktivitet e as në takimin e përbashkët kur fëmijët bashkëbisedojnë. Këto raste zakonisht janë fëmijët me nevoja të veçanta, të cilët kanë edhe çrregullime të tjera dhe bëjnë lëvizje nëpër klasë, ose ulen në një vend dhe nuk bashkohen me grupin. Te këto raste edukatorët nuk ndërmarrin hapa si t'i kycin ata fëmijë në aktivitet dhe komunikim.

Në pak raste edukatorët i japin prioritet të flasin dhe

- Të gjithë të përfshirë, por ka pak komunikim. Në aktivitetet fëmijët kanë prerë materiale me gërshëre, por shumë pak ka komunikim fëmijë-fëmijë dhe edukatore- fëmijë;
- Nuk përfshihen të gjithë, vetëm dy-tre fëmijëve u jepet fjala gjatë bashkëbisedimit në takim të përbashkët. Po ashtu, mësojnë një vjershë dhe atëherë vetëm disa fëmijë e përsërisin;
- Janë të përfshirë në bashkëbisedim;
- Janë të përfshirë të gjithë;
- Jo të gjithë, një fëmijë flet gjuhë angleze, edukatorja nuk e kupton;
- Mundohet t'i japë mundësinë më shumë një fëmijë që ka vështirësi në komunikim;

prezantojnë vetëm fëmijët që kanë vështirësi në komunikim.

Fëmijët që flasin gjuhë angleze, në disa raste, edukatorja nuk i kupton. Fëmija flet gjuhë angleze, por kuptohet nga fëmijët e tjerë, sepse shumë nga ta e kuptojnë gjuhën angleze.

- Të përfshirë në rutinë, pa ndonjë specifikë për një fëmijë që ka vështirësi në komunikim;
- Të gjithë të përfshirë në komunikim;
- Jo të gjithë;
- I përfshin të gjithë fëmijët;
- Një fëmijë nuk përfshihet, ulet te tavolina e edukatores dhe nuk merr pjesë në asnjë aktivitet;
- Një fëmijë flet ndonjë fjalë në gjuhë angleze, por nuk është i përqendruar, nuk përfshihet në aktivitet, lëviz në klasë gjithë kohën;
- Përfshihet, por nuk qëndron në grup, largohet, qëndron i vetmuar.



Sa u përket strategjive që përdor edukatorja me të gjithë fëmijët e grupit për të nxitur komunikim verbal, te përfshirja e fëmijëve në bashkëbisedim rezultatet tregojnë se në të shumtën e rasteve edukatorja i përfshin të gjithë fëmijët në bashkëbisedim, pavarësisht se ndonjëherë ndonjë fëmijë hezitonte të bashkëbisedojë.

Ka raste kur edukatorja pjesërisht i përfshin fëmijët në bashkëbisedim, duke u dhënë mundësinë vetëm atyre që komunikojnë më shumë, pa i nxitur të tjerët.

Në disa raste, edukatorët nuk i përfshijnë fare fëmijët që kanë vështirësi në komunikim, duke i lënë jashtë aktivitetit dhe pa u përfshirë fare as në aktivitet e as në takimin e përbashkët, kur fëmijët bashkëbisedojnë. Këto raste, zakonisht, janë fëmijë me nevoja të veçanta që kanë edhe çrregullime të tjera dhe bëjnë lëvizje nëpër klasë, ose ulen në një vend dhe nuk bashkohen me grupin. Te këto raste edukatorët nuk përpiqen t'i përfshijnë ata fëmijë në aktivitet dhe në komunikim.

Në pak raste, edukatorët u japin prioritet të flasin dhe prezantojnë vetëm fëmijëve që kanë vështirësi në komunikim.

Fëmijët që flasin gjuhën angleze, në disa raste, edukatorja nuk i kupton. Fëmija flet gjuhë angleze, por kuptohet nga fëmijët e tjerë, sepse shumë nga ta e kuptojnë gjuhën angleze.

- **Planifikimi i punës dhe përcaktimi i pritshmërive nga edukatorët për të mësuarit dhe zhvillimin gjuhësor të fëmijëve**

Sa u përket rezultateve të pritura, që edukatorja pret se do t'i arrijnë fëmijët e gjithë grupit, për të përmbushur arritjen e rezultateve të gjuhës dhe komunikimit, bazuar në dokumentacion zyrtar (Standarde të Zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç, të përcaktuara me tregues për moshën përkatëse dhe për fushën përkatëse, apo edhe me Kurrikulën Bërthamë për Klasën Parafillore, te grupet 5-6 vjeç), vërejmë se ato në pak raste

janë paraqitur formalisht, por nuk ka përpjekje që të plotësohen ato pritshmëri me aktivitetet e realizuara.

Në shumicën e rasteve nuk ka pritshmëri për grupin, edukatorët nuk e kanë një dokument apo planifikim që paraqet pritshmëritë, nuk ka një objektivë se ku duhet të arrijë me grupin apo me ndonjë fëmijë veçanërisht, nuk mbajnë vëzhgime për procesin edukativ që realizohet, për të pasur mundësinë pastaj të vlerësojnë arritjet dhe ngeçjet e fëmijëve krahas pritshmërive që do të duhej të kishte.

**- Dhënia e udhëzimeve të qarta nga edukatorët për fëmijët**

Dhënia e udhëzimeve të qarta nga edukatorja, për të kuptuar më mirë fëmijët, është e rëndësishë së veçantë dhe, sipas Willard (2023), nëse fëmijët nuk i kuptojnë udhëzimet, ata mund të kenë vështirësi me gjuhën pranuese<sup>2</sup> dhe dhënia e udhëzimeve të shkurtra e të qarta, si dhe shtimi i shenjave vizuale, mund të ndihmojë ata të kuptojnë... hap pas hapi dhe të ndihmojë në zbutjen e çdo vështirësie në përpunimin e atyre udhëzimeve verbale (Willard, 2023).

Në të shumtën e rasteve, edukatorët japin udhëzime të qarta për të gjithë fëmijët dhe, në disa raste, i mbështesin me shembuj konkretë, nga jeta e përditshme, që të kuptohen më lehtë nga fëmijët.

Por, nuk janë të pakta rastet kur edukatorët nuk janë plotësisht të qarta në dhënien e udhëzimeve: ose i japin shumë shkurt udhëzimet, ose flasin nga një pozitë e papërshtatshme për fëmijët (në këmbë, ose pas shpine), e këto ndikojnë në marrjen e drejtë të mesazhit nga

---


<sup>2</sup> Gjuha pranuese – komunikim, që përfshin të kuptuarit e asaj që të tjerët e thonë në bisedë ose në ligjëratë (Kroncke, 2023).

fëmijët, sepse ata kuptojnë më mirë kur i shfrytëzojnë më shumë shqisat dhe kur udhëzimet thjeshtohen.

Disa nga edukatorët kalojnë shpejt gjatë dhënies së udhëzimeve, pa u marrë shumë me fëmijët që kanë vështirësi në komunikim verbal ose, në disa raste, janë edhe fëmijë me nevoja të veçanta dhe nuk janë të kyçur në aktivitete dhe nuk i marrin fare mesazhin dhe udhëzimet e edukatores. Në raste të vogla, edukatorët japin edhe udhëzime individuale për fëmijët që nuk i marrin me lehtësi udhëzimet që jepen në grup të madh ose të vogël, e kjo është më se e domosdoshme të bëhet për të gjithë fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal.

- **Mbajtja e kontaktit me sy** Qasja dhe pozita e edukatores në raport me fëmijët ka shumë rëndësi edhe për zhvillimin e komunikimit verbal, gjatë fazës së zhvillimit të tyre.

Sipas Kilian-Ross (2022), kontakti me sy është një formë e komunikimit joverbal dhe së bashku me vëmendjen e përbashkët janë dy aftësi shumë të rëndësishme, që formojnë themelin për zhvillimin e gjuhës dhe të folurit (Kilian-Ross, 2022).



*Fig. 9. Edukatorja mban kontekstin me sy me fëmijët e grupit*

Rezultatet tregojnë se shumica e edukatoreve nuk e kanë qëndrimin e duhur në raport me fëmijët. Vetëm 13 edukatore e kanë mbajtur pozitën e duhur dhe kontaktin me sy gjatë komunikimit me fëmijët, 15 edukatore pjesërisht e kanë zhvilluar komunikimin duke mbajtur kontaktin me sy. Në të shumtën e rasteve, kanë komunikuar me gjithë grupin, duke mos e vënë qasjen e drejtpërdrejtë të kontaktit dhe të vëmendjes për secilin fëmijë, ndërsa 6 edukatore kanë qëndruar në këmbë, ose prapa fëmijëve të ulur në rreth

**- Nxitja e komunikimit verbal nga edukatorët te fëmijët**

Nxitja e komunikimit verbal nga edukatorja mund të arrihet sapo ajo të jetë e gatshme t'i njohë fëmijët, nga një vëzhgim paraprak, për të përshtatur edhe aktivitetet për fëmijët e grupit. Sipas Virtual Lab School (2021), edukatorja ka mundësi të mahnitshme për të nxitur gjuhën dhe bisedat në klasën parashkollore. Ka raste të panumërta gjatë ditës që të nxiten fëmijët të flasin... me planifikim të kujdesshëm dhe ju mund t'i përshtatni dhe futni strategjitë e komunikimit në përvoja dhe rutina të shumta gjatë gjithë ditës (Virtual Lab School, 2021). Në të shumtën e rasteve, edukatorja nxit vëmendjen e fëmijëve për t'u kuptuar drejt nga fëmijët, duke thirrur emrin e

fëmijëve, në veçanti fëmijëve me vështirësi në komunikim verbal. I paraprin me rrokje në rastet kur fëmija nuk kupton, me këshilla në mënyrë të veçantë, në orientim për zgjedhjen e ngjyrave, bën ndonjë pyetje për t'i nxitur që të kthejnë përgjigje etj.

Ka raste kur edukatorët nuk i nxisin, nuk i mbështesin dhe nuk ndalen të shikojnë nëse të gjithë fëmijët po e kuptojnë dhe po e marrin mesazhin nga edukatorja.

Në rastet kur ka fëmijë me nevoja të veçanta edukatorët i marrin afër vetes, i mbajnë për dore, bëjnë përpjekje t'i përfshijnë në bashkëbisedim dhe në aktivitete, por nuk është e mundur, sepse ata ose lëvizin shumë nëpër klasë, ose ulen në një vend dhe nuk duan të përqendrohen në aktivitet. Kjo paraqet vështirësi në punën e edukatoreve, sepse, në të shumtën e rasteve, nuk kanë mbështetje nga një edukatore tjetër ose nga një asistente.

**1.7.2.2**  
**Strategjitë**  
**që i zbaton**  
**edukatorja për**  
**të zhvilluar**  
**komunikimin**  
**verbal me**  
**fëmijët që kanë**  
**vështirësi në të**  
**folur**

Përveç strategjive që edukatorja i përdor me të gjithë fëmijët e grupit, për të nxitur dhe zhvilluar komunikimin verbal të fëmijëve, ka edhe strategji specifike që edukatorja duhet të përdorë, për të nxitur dhe zhvilluar komunikimin verbal të fëmijët që kanë vështirësi në të folur. Rezultatet e mëposhtme paraqesin strategjitë që i kanë përdorur respondentët e këtij hulumtimi për zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijët që kanë vështirësi në të folur:

**- Vëmendje të**  
**plotë për**  
**fëmijët me**  
**vështirësi në**  
**komunikimin**  
**verbal**

Në të shumtën e rasteve, edukatorët ka vëmendje të theksuar për fëmijët me vështirësi në komunikim, i pyesin kohë pas kohe (në rastet kur ka asistente, ato u kushtojnë më shumë vëmendje fëmijëve). Por, ka edhe shumë raste

kur edukatorët nuk e kanë vëmendjen e theksuar tek ata fëmijë dhe trajtohen sikur të gjithë fëmijët e tjerë.

Në pak raste u kushtojnë vëmendje të tepruar fëmijëve me vështirësi në komunikim, duke u kërkuar të flasin, të tregojnë, të përgjigjen etj...dhe shpesh kalojnë në siklet për ata fëmijë dhe për fëmijët e tjerë.

- Të folurit më ngadalë nga edukatorët që të kuptohen më mirë nga fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal

Në më shumë se gjysmën e rasteve të vëzhguara, edukatorët nuk e përshtatin të folurit për fëmijët që kanë vështirësi në të folur. Vazhdojnë të flasin me rrjedhën e njëjtë, pavarësisht a kuptojnë apo nuk kuptojnë fëmijët që kanë vështirësi.

Në më pak se gjysmën e rasteve, edukatorët ndalen të flasin më ngadalë, duke shikuar a po kuptojnë fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal dhe ndonjëherë edukatorët e përsërisin ndonjë fjalë ose edhe e ndajnë në rrokje.

Në pak raste, edhe pse edukatorët flasin ngadalë, kuptueshëm dhe me ton të përshtatshëm për t'u kuptuar më lehtë, përsëri fëmijët nuk u kushtojnë vëmendje, sepse ka edhe fëmijë me nevoja të veçanta, të cilët kanë edhe vështirësi në komunikimin verbal dhe vështirë përqendrohen në atë se çfarë thonë edukatorët

- Durim dhe pritje për të nxjerrë fëmijët ndonjë fjalë apo fjali

Në të shumtën e rasteve, edukatorët i presin derisa fëmijë të fillojnë të flasin ndonjë fjalë, insistojnë të marrin ndonjë fjalë dhe i stimulojnë kohë pas kohe. Në pak raste fëmijët që flasin gjuhën angleze, përgjigjen në gjuhë angleze. Mësuesja flet shqip, fëmija përgjigjet në gjuhë angleze.

Në pak raste fëmijët u përgjigjen edukatoreve në vesh, pa i dëgjuar të tjerët.

Rastet e tjera, edukatoret nuk presin të marrin përgjigje nga fëmijët që kanë vështirësi në të folur. Tejkalohehen fëmijët kur u vjen radha të flasin.

**- Zbatimi i  
përvojave që  
sjellin rezultate  
- nxitja**

Në të shumtën e rasteve, edukatoret përdorin strategji të komunikimit për të gjithë fëmijët e grupit dhe më pak përdorin strategji apo përvoja të veçanta, të cilat mund të sjellin rezultate në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët. Vazhdojnë aktivitetin me fëmijët e tjerë, shpeshherë duke i tejkeluar fëmijët që nuk përgjigjen.

Në pak raste edukatoret përdorin figura dhe mjete tjera që t'i nxisin fëmijët të flasin ose u japin një libër me ilustrime dhe fëmijët komentojnë një ilustrim me dy tri fjalë, bëjnë ndonjë lëvdatë, i motivojnë fëmijën të flasin etj. Në një rast, fëmija nuk komunikon asnjëherë gjatë bashkëbisedimit të edukatores me fëmijët në grup të madh, por vetëm kur kalon në një kënd dhe merr në dorë një libër me ilustrime, atëherë fillon t'i thotë emrin veturës që sheh në ilustrim, të imitojë lëvizjet dhe zhurmën e veturës etj. Ka raste kur fëmijët janë me nevoja të veçanta dhe kanë vështirësi në komunikimin verbal, pavarësisht insistimit të edukatoreve, nuk janë të gatshëm të përqendrohen për të komunikuar bashkë.

**- Inkurajimi  
i bashkë-  
bisedimit  
edukatore -  
fëmijë**

Pothuajse në gjysmën e rasteve të vëzhguara edukatoret i inkurajojnë fëmijët në bashkëbisedimin edukatore-fëmijë. I nxisin të flasin, presin përgjigjet, i stimulojnë të flasin vetëm një fjalë, i flasin pak për prindërit për të nxitur bisedën, bëjnë pyetje etj. Por, afërsisht gjysma e rasteve të tjera të vëzhguara nuk i inkurajojnë fëmijët të bashkëbisedojnë me edukatoret. Nuk insistojnë, bëjnë pak

përpyqje dhe vazhdojnë, por ka raste kur fëmijët distancohen nga aktiviteti dhe nuk bëhen shumë përpyqje nga edukatorët për t'i përfshirë në biseda dhe në aktivitete.

- **Inkurajimi i bashkë bisedimit fëmijë – fëmijë** Në të shumtën e rasteve, edukatorët nuk i inkurajojnë fëmijët me vështirësi në të folur, të komunikojnë me fëmijët e tjerë, kur dihet që fëmijët më lehtë komunikojnë dhe shprehen me moshatarët e tyre. Edukatorët flasin më shumë në mënyrë urdhërore: shko atje, bëje këtë, e jo me mirësjellje, të nxisin komunikimin fëmijë-fëmijë. Në pak raste nxitet komunikimi fëmijë-fëmijë: në lojëra, në aktivitete të përbashkëta, në lojën me role etj.
- **Përsëritja e fjalëve për të kuptuar fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal** Në afër gjysmën e rasteve të vëzhguara edukatorët i përsërisin fjalët, që të kuptojnë fëmijët që kanë vështirësi në të folur, në ndonjë rast edhe i ofrojnë më afër vetes fëmijët dhe mundohen t'u japin sqarime. Në rastet e tjera, edukatorët vazhdojnë rrjedhshëm komunikimin me fëmijët, pa u ndalur, pa i përsëritur, ose pa u kushtuar shumë vëmendje nëse i kuptojnë apo jo fëmijët që kanë vështirësi.
- **U kërkohet fëmijëve të marrin fjalën dhe u japin mundësi të shprehen** Në gjysmën e rasteve, edukatorët u kërkohet fëmijëve të marrin fjalën, sidomos në takimet e përbashkëta, kur flasin me radhë, të prezantojnë kalendarin ditor, të udhëheqin ndonjë lojë, e në disa raste presin edhe ndonjë shenjë të komunikimit joverbal, pohim me kokë, që po kuptojnë, marrin mesazhin dhe realizojnë atë që thonë edukatorët, u japin ndonjë lodër për t'i mbajtur në aktivitete etj. Në rastet e tjera, edukatorët nuk u kërkohet të flasin fëmijëve me vështirësi në komunikim. Edhe nëse u vjen radha, nuk këmbëngulin të marrin përgjigje apo ndonjë fjalë nga ata fëmijë.



- **U kërkojnë fëmijëve të ndihmojnë fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal** Në të gjitha rastet, edukatorët komunikojnë vetë me fëmijët, por nuk u kërkojnë fëmijëve të tjerë të ndihmojnë ata fëmijë gjatë komunikimit.

Ka raste kur fëmijët që kanë vështirësi në komunikim janë të pashoqërueshëm dhe nuk komunikojnë në asnjë mënyrë me askënd, as me edukatorët. Por, edhe në rastet kur flasin ndonjë fjalë, nga edukatorët nuk kanë ndonjë iniciativë që nxisin mbështetjen nga fëmijët e tjerë.

- **Japin vetë përgjigje sugjестive derisa presin përgjigje nga fëmijët** Në shumicën e rasteve, edukatorët japin vetë përgjigje kur fëmijët nuk flasin, p sh. kështu.... apo?

Kjo është një përgjigje sugjестive, që fëmijët shpeshherë e pohojnë apo e mohojnë me mimikë, apo me lëvizje të kokës, por nuk është përgjigje e fëmijëve.

Duke qenë të pranishme vëzhgueset në klasë, shpesh edukatorët përgjigjen para fëmijëve të tjerë, duke dhënë një arsyetim se ky fëmijë nuk flet dhe kjo mund të jenë përgjigjja ose arsyeja etj. Kjo ndodh në prani të fëmijëve të tjerë dhe ka raste kur nuk priten mirë nga fëmijët që kanë vështirësi në të folur, mund të kuptojnë këtë situatë dhe ka raste edhe kur reagojnë me sjellje të tjera, duke u larguar nga aktiviteti, duke i rënë vetes me duar etj. Në rastet e tjera nuk japin përgjigje vetë edukatorët, por vazhdojnë rrjedhën e bashkëbisedimit me fëmijët e tjerë.

- **Komentojnë ilustrimet dhe fotot për fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal** Në të shumtën e rasteve, nga edukatorët nuk komentohen ilustrimet, veçmas për fëmijët me vështirësi në komunikimin verbal, por komentohen gjatë leximit dhe nuk kanë ndonjë nxitje të flasin për fëmijët që kanë vështirësi në komunikim. Në disa raste ka komentim të ilustrimeve nga edukatorja, për fëmijët me vështirësi në komunikim, si p.sh. kur i shikojnë ilustrimet e frutave bëjnë ndonjë pyetje edukatorët dhe presin që fëmijët të përgjigjen. Po ashtu, edhe për kafshët etj. Ka edhe raste kur, me gjithë

përpyekjet, edukatorët nuk ia arrijnë qëllimit, për arsye se fëmijët në fjalë nuk përqendrohen tek ilustrimet.

- **Zbatimi i lojës si strategji për të nxitur komunikimin verbal te fëmijët** Rezultatet e hulumtimit tregojnë se në disa raste realizohen aktivitete përmes lojës, por nuk janë lojëra që e nxisin komunikimin verbal, që zhvillojnë ndonjë rrokje ose ndonjë fjalë të thjeshtë, që fëmijët të përsërisin më lehtë, apo lojë fjalësh, këngë dhe vjersha.

Ndonjëherë, edukatorët i kanë në fokus fëmijët që kanë vështirësi në të folur, pasi ata fëmijë janë të shpërqendruar dhe bëjnë shumë lëvizje.

Në shumicën e rasteve, nuk realizohet loja si strategji për të nxitur të folurit, por realizohen aktivitete në grupe të mëdha dhe të vogla, në aktivitete të orientuara, dhe jo në lojëra që nxisin të mësuarit dhe komunikimin verbal

- **Përdorin teknika të tjera specifike për të stimuluar/ushtruar/lehtësuar të folurit** Në shumicën e rasteve, edukatorët nuk përdorin ndonjë teknikë, mjet apo metodë të veçantë për stimulim/ushtrim të të folurit.

Në disa raste, edukatorët e mbështesin të folurit me ndonjë mjet demonstrues, apo me ndonjë lodër, e ndajnë fjalën në rrokje, apo flasin me gjestikulacione, vendosin gjëra para fëmijëve që t'i prekin ato, i pyesin veçanërisht se çfarë janë, në mënyrë që fëmijët të kuptojnë dhe të shprehin pastaj më lehtë.

**1.7.2.3. Mjedisi, mjetet dhe materialet që nxisin komunikimin verbal** Në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët që kanë vështirësi në të folur ndikon edhe mjedisi në të cilin edukatorët e realizojnë punën e tyre me fëmijët, si dhe mjetet dhe materialet që i përdorin edukatorët për të nxitur dhe zhvilluar të folurit te fëmijët. Rezultatet e hulumtimit, për rolin e edukatores në përgatitjen e mjedisit stimulues

dhe në përdorimin e mjeteve dhe materialeve që nxisin të folurit te fëmijët, janë paraqitur në vazhdim:

- Edukatorët përgatisin mjedisin, mjetet dhe materialet, për të nxitur komunikimin me fëmijët që nuk flasin**

Në pak se gjysmën e rasteve të vëzhguara edukatorët i realizojnë aktivitetet në hapësira të mjaftueshme, të përshtatshme për fëmijët. Ata mund të dëgjojnë, të komunikojnë, të lëvizin dhe të luajnë lirshëm.

Në më shumë se gjysmën tjetër ka hapësira të ngushta, të vogla, në ndonjë rast në mes të klasave të tjera (sidomos në institucione parashkollore private), nuk ka mjete dhe materiale adekuate për të realizuar mirëfilli aktivitetet që nxisin të folurit te fëmijët.
- Ka libra me ilustrime dhe të qasshme për fëmijët**

Në më pak se gjysmën e rasteve të vëzhguara ka libra me ilustrime, të cilat i përdorin edukatorët dhe fëmijët, shpeshherë për të përcjellë me ilustrime një tregim të lexuar, e ndonjëherë edhe vetë fëmijët i përdorin librat, i shikojnë ilustrimet, flasin ndërmjet vete. Në një rast konkret vetëm makinat e ilustruara në libra e nxisin fëmijën të flasë me të tjerët.

Në më shumë se gjysmën e rasteve të tjera ose nuk ka fare libra me ilustrime, ose ka libra të pashfletuar nga fëmijët, për arsye se nuk janë në nivelin e tyre, për t'i marrë vetë ata kur kanë nevojë, janë të mbyllura në dollapë, ose te klasa parafillore i kanë vetëm librat e pakos “Mësoj si nxënës, luaj si fëmijë” dhe asnjë libër tjetër.
- Ambientet edukative kanë mjete dhe materiale që nxisin komunikimin verbal**

Në më pak se gjysmën e rasteve, edukatorët e kanë pasuruar ambientin me mjete dhe materiale që mund të nxisin të folurit te fëmijët, siç janë: librat, mjetet muzikore, mjetet e vendosura në mur, në disa raste mjete të metodës “Montesori”, forma gjeometrike etj. Në më shumë se gjysmën e rasteve ka pak ose nuk ka fare mjete që nxisin

të folurit të fëmijët, përveç ngjyrave, letrave, blloqeve. Fëmijët mund të zhvillohen individualisht edhe pa komunikuar me të tjerët dhe si pasojë nuk e ndiejnë të nevojshëm shumë komunikimin në grup. Prandaj, nxitja e punës në grupe me shumë materiale do të ndihmonte komunikimin e fëmijëve.

- **Ka hapësira për grupe të vogla, në të cilat fëmijët mund të shikojnë, të dëgjojnë dhe të prekin fotot, figurat etj.** Në afërsisht gjysmën e rasteve ka hapësira për punë në grupe të vogla, në të cilat fëmijët mund të vizatojnë, të ngjyrosin, të flasin, të prekin, të dëgjojnë etj. Këto hapësira shfrytëzohen mirë edhe nga fëmijët që kanë vështirësi në komunikim, por në gjysmën tjetër të rasteve fëmijët nuk i kanë këtë mundësi, për shkak se nuk i kanë ofruar edukatorët komoditetin, ose për arsye se fëmijët që kanë vështirësi në komunikim nuk kanë përqendrim në aktivitete, bëjnë lëvizje etj.
- **Ka qasje në hapësira të ndryshme në institucione dhe jashtë, në të cilat fëmijët mund të nxiten për komunikim verbal: mjedisi i jashtëm, lojërat në natyrë etj.** Ka pak raste kur shfrytëzohen hapësirat jashtë klasës dhe oborret për të nxitur komunikimin verbal të fëmijëve. Në shumicën e rasteve, nuk kanë hapësira të jashtme adekuate për fëmijët dhe në rastet kur ka hapësirë, ato nuk shfrytëzohen si duhet. Kanë vendosur topa e lodra, por bari në oborre është tërësisht i pashkelur, sikur shërbejnë për dekor ato kënde lojërash në oborr dhe jo të shfrytëzohen nga fëmijët për zhvillimin e gjithanshëm të tyre, e në këtë rast edhe për zhvillimin e komunikimit verbal.

## 1.8. KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Sa u përket të dhënave të përgjithshme dhe qasjes së fëmijëve me vështirësi në të folur, në kopshte, është e nevojshme që fëmijëve me vështirësi në të folur t'u bëhet

një vlerësim profesional para se të vijë në kopsht. Kopshti dhe edukatorja të kenë një pasqyrë për fëmijën dhe të ndërmarrin hapa që të përgatiten për trajtimin e këtyre rasteve në mënyrën që është e nevojshme. Është e nevojshme të angazhohen ekipe profesionale të komunave për vlerësim, për fëmijët me vështirësi në të folur, por, edhe pse kjo çështje është e rregulluar me udhëzim administrativ, një gjë e tillë nuk ndodh. Nevojitet bashkëpunim reciprok edukatore-prind-profesionist adekuat, që të vlerësohen fëmijët, të hartohet plan individual sipas vlerësimeve dhe të përkrahen në zhvillimin e tyre në të folur, të ndërgjegjësohen prindërit për nevojat e një vlerësimi dhe trajtimi adekuat për fëmijët që ka vështirësi në të folur. Ka nevojë për mbështetje me asistente për këta fëmijë. Është i vogël numri i fëmijëve që kanë asistente dhe kryesisht ato angazhohen nga prindërit e fëmijëve. Ka nevojë për koordinimin e punës edukatore-asistente, sepse në rastet kur ka asistente, ka pak angazhim të edukatoreve për punë me këta fëmijë, sepse i lihet gjithë puna asistentes.

Lidhur me rolin e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal të të gjithë fëmijëve në grup, konkludohet se edukatorët në planifikimet e punës me fëmijë nuk kanë vendosur pritshmëri për arritjet e fëmijëve në zhvillimin e komunikimit verbal dhe nuk kanë bërë ndonjë vlerësim të arritjeve të tyre, që pastaj, bazuar në atë, të hartojnë plane me pritshmëri për zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijët. Edukatorët japin udhëzime të qarta për fëmijët, por është e nevojshme që, për t'u kuptuar nga të gjithë fëmijët, udhëzimet të jenë më konkrete. Nevojitet që edukatorët të kenë qëndrimin e duhur në raport me fëmijët dhe të shikohen ata në sy kur bisedojnë, por kjo në shumicën e rasteve nuk ndodh.

Sa u përket strategjive që i zbatojnë edukatorët në punën me fëmijët që kanë vështirësi në të folur, është e

nevojshme që edukatorët të zbatojnë më shumë strategji për këta fëmijë, sepse kanë nevojë për vëmendjen e plotë, gjë që në praktikë nuk u kushtohet në masën e duhur. Ka nevojë që edukatorët të flasin më ngadalë për t'u kuptuar nga fëmijët dhe të kenë durim për të pritur ndonjë përgjigje nga fëmijët që kanë vështirësi në të folur. Disa edukatore përdorin mjete vizuale, ilustrime dhe kartela që nxisin të folurit të fëmijët, por është e nevojshme që këtë ta bëjnë të gjitha edukatorët. Është e nevojshme që edukatorët të inkurajojnë dhe të nxisin bashkëbisedimin edukatore-fëmijë dhe fëmijë-fëmijë; të përsërisin fjalët disa herë për t'u kuptuar dhe për të kthyer përgjigje nga fëmijët; t'u japin mundësinë fëmijëve të marrin fjalën ose të shprehen, por edhe kjo qasje është trajtuar fare pak. Ka nevojë t'u kërkohet fëmijëve të tjerë të komunikojnë me fëmijën që ka vështirësi në të folur, sepse fëmijët më lehtë shprehen me bashkëmoshatarët e tyre, dhe po ashtu profesionistët paraqesin nevojën e socializimit të fëmijëve për të zhvilluar të folurit. Është e nevojshme që edukatorët të mbështesin fëmijët kur flasin ndonjë fjalë, por jo të japin vetë përgjigje në emër të fëmijëve. Një strategji shumë efektive për zhvillimin e komunikimit verbal konsiderohet se është loja, por rezultatet e hulumtimit tregojnë se loja, këngët, rimat, nuk përdoren mjaftueshëm si strategji nga edukatorët për të zhvilluar komunikimin verbal të fëmijët që kanë vështirësi në të folur, edhe pse loja është parim bazë në të gjitha dokumentet zyrtare të edukimit parashkollor në Kosovë.

Lidhur me përgatitjen e mjedisit, mjeteve dhe materialeve nga edukatorët, për të nxitur zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijët që kanë vështirësi në të folur, mund të themi se përdoren hapësira të brendshme, të cilat ofrojnë mundësi që fëmijët të flasin, si në bashkëbisedim me gjithë grupin po ashtu edhe në grupe të vogla. Nuk ka libra të mjaftueshëm me ilustrime dhe në disa raste nuk janë të qasshme për fëmijët, për t'i shfrytëzuar kur të kenë nevojë

dhe për të nxitur të folurit rreth atyre ilustrimeve. Po ashtu, është e nevojshme që të shfrytëzohet mjedisi i jashtëm, të realizohen aktivitete në natyrë, sepse të gjithë fëmijët, posaçërisht ata që kanë vështirësi në të folur, mund të nxiten nga natyra dhe gjërat përreth, të cilat e zhvillojnë të folurit.

Planifikimi, përshtatja e aktiviteteve për moshën, arritja e rezultateve, standardeve dhe treguesve për moshën e caktuar, në këtë rast për zhvillimin e komunikimit verbal, janë të obligueshme për edukatorët, prandaj duhet të gjenden mënyrat, rrugët, strategjitë, mjetet dhe materialet që u ofrojnë mundësi fëmijëve të zhvillohen dhe të mos kenë vështirësi në zhvillimin e komunikimit verbal. Zhvillimi profesional i edukatoreve për zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët që kanë vështirësi në të folur është i domosdoshëm.





## KAPITULLI II

### II. ROLI DHE RËNDËSIA E BASHKËPUNIMIT EDUKATORE-PRIND NË MBËSHTETJEN E FËMIJËVE ME VËSHTIRËSI NË TË FOLUR

Njëra ndër objektivat e këtij kapitulli është bashkëpunimi edukatore-prind, në favor të stimulimit të fëmijëve për zhvillim në aspektin e gjuhës dhe komunikimit, duke e ditur se gjuha dhe komunikimi fëmijëve ua mundësojnë kuptimin me të tjerët, sqarimet rreth fenomeneve dhe gjërave të reja, të cilat ata i hasin dhe i përjetojnë për çdo ditë, kur janë në fillimin e jetës së tyre.

#### 2.1. Konteksti teorik

Gjuha është mjeti më domethënës për zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve, veçanërisht për atë kognitiv, përmes së cilës ai kupton, informohet dhe komunikon. Zhvillimi gjuhësor, pasurimi i leksikut dhe komunikimi të fëmijët avancohen vetëm përmes ndërveprimit me folës të tjerë, moshatarë ose të rritur, nëpërmjet të cilëve ai mëson dhe përsërit fjalët që i di.

Sipas ekspertëve të zhvillimit të fëmijëve, roli i prindit në nxitjen e zhvillimit të të folurit dhe nxënies, përgjatë fëmijërisë së hershme, është shumë esencial dhe përcaktues. Këto fakte bëjnë që niveli i zhvillimit të fëmijës (përfshirë edhe zhvillimin gjuhësor) varet ose edhe përcaktohet nga qasja mbështetëse socio-emocionale e prindit dhe krijimi i mjedisit dhe rrethanave stimuluese në shtëpi. “Sipas ekspertëve, fëmijët që u ofrohet më shumë komunikim, më shumë lexim i përrallave apo librave në vazhdimësi, nga ana e

prindit, krijojnë avantazh në aspektin gjuhësor, përfshirë këtu leksikun, nxënien, aftësitë komunikuese dhe krijimin e vetëbesimit në aspektin social dhe emocional, në komunikim me bashkëmoshatarët dhe të rriturit” (Hirsh-Pasek & Golinkoff, 2012, f. 78).

Po ashtu fëmijët, prindërit e të cilëve komunikojnë verbalisht më shpesh me ta dhe i inkurajojnë të flasin më shumë, tregojnë një nivel më të lartë të zhvillimit gjuhësor. Ulja e mundësive të komunikimit mund të çojë në një zhvillim më të ngadalshëm gjuhësor të fëmijëve (Sego, 2009).

Për këtë arsye, fëmijët në institucione parashkollore nuk shkojnë me aftësi të njëjta në asnjë aspekt të zhvillimit të tyre, posaçërisht në kapacitetet gjuhësore e kognitive (këto të dyja janë të lidhura ngushtë dhe varen nga njëra-tjetra në mënyrë reciproke).

Përderisa fëmijët zhvillimin më të hovshëm dhe ndryshimet më të mëdha i pësojnë përgjatë viteve të para të jetës, prindi, që është kujdestari dhe mësuesi i tij i parë, ka rol përcaktues në zhvillimin dhe të ardhmen e fëmijës. Prandaj, bashkëpunimi, konsultimi dhe planifikimi i përbashkët i edukatores me prindin, lidhur me aftësitë/ngecjet dhe nevojat e fëmijës, është i një rëndësie të veçantë dhe i domosdoshëm.

Rëndësia e pakontestueshme e bashkëpunimit edukatore-prind është konfirmuar/obliguar edhe me Ligjin mbi edukimin parashkollor, më saktësisht Ligji, nr. 02/L-52 - 2006 (MASHTI, 2006). Nga bashkëpunimi adekuat edukatore-prind ka përfitime të shumanshme. Prindi ka lehtësime dhe plotësime në përkujdesjen ndaj fëmijës së tij, edukatorja informohet dhe orientohet në mënyrë më specifike për punën dhe përkushtimin individual ndaj fëmijës, kurse, në mënyrë të posaçme, ka përfitime fëmija, sepse përmes këtij bashkëpunimi atij i trajtohen dhe sanohen nevojat.

Sipas Plakolli & Aliu-Gashi, në hulumtimin e realizuar, nga prindërit është theksuar se “bashkëpunimi i tyre me edukatoren është i domosdoshëm për zhvillimin e fëmijës në përgjithësi dhe në veçanti aty ku fëmijët kanë ngecje” (Plakolli & Aliu-Gashi, 2016, f. 59).

Komunikimi dhe zhvillimi i gjuhës në të gjitha fazat është një proces kompleks dhe përfshin fusha të tjera të zhvillimit, siç janë aftësitë njohëse, dhe përmirësohet nga të dhënat nga mjedisi (familja, kujdestarët, bashkëmoshatarët, përvojat, aktivitetet etj.). Komunikimi dhe gjuha na ndihmojnë të mendojmë, të mësojmë, të zgjidhim problemet, të kujtojmë dhe të kuptojmë atë që përjetojmë.

Përmirësimi i të folurit, gjuhës dhe komunikimit, të fëmijëve parashkollorë është faktor fundamental i zhvillimit të përgjithshëm, posaçërisht atij kognitiv të fëmijës (Bilton & Watts, 2020). “Të ndihmohet fëmijët të ndërtojnë fjalorin dhe të zhvillojnë aftësitë gjuhësore për të marrë atë që kanë nevojë dhe duan është një obligim thelbësor i shërbimit familjar dhe institucional, përgjatë fëmijërisë së hershme” (Fiechtner, 2017).

Sipas ekspertëve, që fëmija të përparojë në çdo aspekt zhvillimor të tij dhe të aftësohet për një jetë të suksesshme, bazat e këtij zhvillimi krijohen përmes marrjes së informatave dhe aftësimin të tij për komunikim me të rriturit dhe me bashkëmoshatarët. Përveç tjerash, nga aftësia e fëmijës për të folurit dhe krijimi i raporteve me të tjerët varet edhe gjendja socio-emocionale e tij, e cila është përcaktuese edhe e aftësimin të fëmijës në të folur, në krijim të raporteve dhe komunikim me ta, si dhe në zhvillim të përgjithshëm të fëmijës kognitiv.

Ngecjet e fëmijëve në të folur dhe komunikim mund të sanohen vetëm përmes një bashkëpunimi të përkushtuar dhe të qëlluar, ndërmjet dy partnerëve që

merren me kujdesin dhe zhvillimin e fëmijëve: edukatores e prindit, qoftë edhe duke përfshirë, në raste, edhe ekspertë profesionalë gjuhësorë, si ndihmës dhe konsulentë. Nga niveli dhe cilësia e këtij ndërveprimi (prind-edukator) varet zhvillimi gjuhësor i fëmijës dhe zhvillimi tërësor për të ardhmen.

Nga bashkëpunimi edukatore-prind dhe krijimi i raporteve të hapura, të sinqerta dhe konsultuese reciprokisht, varet ngritja e kapaciteteve të fëmijës në çdo aspekt. Zhvillimi, mirërritja dhe mirëqenia e fëmijëve parashkollorë varen nga përkushtimi dhe përgjegjësia e prindit në shtëpi, edukatores në institucion edukativ, dhe bashkëpunimi i hapur e pa rezervë ndërmjet këtyre dy partnerëve. Fëmijët e vegjël zhvillohen dhe mësojnë në kontekstin e marrëdhënieve. Një marrëdhënie e besueshme dhe e kujdesshme mësues-fëmijë është thelbësore për zhvillimin optimal të fëmijëve (Chazan-Cohen et, al, 2017).

Rruga zhvillimore dhe edukative për fëmijët fillon në familje. Prindi duhet të jetë ekspert për fëmijën e vet dhe të përkujdeset për aftësim të përgjithshëm të tij. Kështu prindi është ai që nga fillimi i jetës së fëmijës ka ndikim e përgjegjësi të gjithanshme për fëmijën, por në mënyrë të veçantë është përgjegjës për zhvillimin e aftësive gjuhësore të fëmijës dhe pasurimin e leksikut të tij. Sipas ekspertëve të parashkollorit, gjuha, madhësia e fjalorit dhe mënyra e komunikimit dhe reflektimit verbal të fëmijëve, deri në moshën e tyre pesëvjeçare, pohohen si kusht thelbësor për suksesin e secilit fëmijë në të ardhmen e tij. Po ashtu, ekspertët e kësaj fushe kanë hulumtuar dhe kanë konfirmuar se gjuha, në përgjithësi dhe fjalori në veçanti, zhvillohet më së miri në kontekstin e marrëdhënieve, në ndërveprime kuptimplota, reciproke, për gjërat që janë të këndshme dhe të rëndësishme për fëmijën. Kurse

marrëdhënia adekuate fëmijë-prind është themeli, mbi të cilin ndërtohet dhe zhvillohet gjuha te fëmijët.

Mirëpo, krahas prindit në shtëpi, rol përcaktues të nivelit të avancimit gjuhësor të fëmijëve parashkollorë kanë edhe edukatorët në institucionin edukativ, në të cilin kanë ndikim të madh angazhimi, përzgjedhja dhe zbatimi i strategjive adekuate nga ana e edukatores. Në kontekstin e aftësimit të fëmijës në të folur është primar ofrimi i mundësive për bashkëbisedim dhe krijimi i situatave që fëmija të mund të shprehet verbalisht sa më shumë. Kjo është strategjia thelbësore për zhvillim të të folurit, përmes aktiviteteve mbështetëse të këtij aspekti të zhvillimit të fëmijëve.

Krahas rolit dhe rëndësisë së edukatores për mbështetje e stimulim gjuhësor të fëmijës, rëndësinë e saj e shton edhe identifikimi i fëmijëve me vështirësi gjuhësore në kontekstin e identifikimit fillestar, për trajtim sa më të hershëm (Christopoulos & Kean, 2020).

Nga ekspertët parashkollorë potencohet se prioritet parësor i shërbimit ndaj fëmijëve në institucionet parashkollore duhet të jetë mësimi i gjuhës, si kusht thelbësor për suksesin e mëturjesheëm jetësor të fëmijëve. Stimulimi i gjuhës verbale dhe njoftimi gradual me gjuhën e shkruar përbëjnë prioritetet e edukimit parashkollor, sepse këto dy specifika kanë të bëjnë me të gjitha fushat e të nxënit.

## **2.2. Strategji mbështetëse në të folurit e fëmijës, për prindër dhe edukatore**

Parashkollorët kanë nevojë që përgjatë kujdesit të përhershëm ndaj tyre edhe t'u ofrohet mundësia për të marrë pjesë në aktivitete të këndshme e argëtuese për ta (si në shtëpi ashtu edhe në institucion), përmes së cilave krijojnë aftësi të reja emocionuese dhe stimuluese për komunikim efektiv, në kuadër të marrëveshjeve dhe krijimit të raporteve sociale me të rriturit dhe moshatarët. Kjo është një alternativë

thelbësore për mbështetje të fëmijës në zhvillim të të folurit. Këto raporte (krijimi i raporteve dhe komunikimi me fëmijët e tjerë dhe të rriturit që i ka përreth vetes) fëmijës i ofrojnë mundësinë për bashkëbisedim, diskutim, krijim, lojë dhe shprehje të emocioneve. Në kuadër të krijimit të mundësive gjuhësore/komunikuese, nga prindërit dhe edukatorët, fëmijëve është mirë t'u ofrohen mënyra të ndryshme/alternativa, përmes së cilave nxitet ngritja e kapaciteteve gjuhësore, si: zbatimi i muzikës, vallëzimit, rrëfimit, përrallave, leximit, dramatizimit etj. Për aftësim të fëmijëve në të shprehur e në komunikim, si edukatorët ashtu edhe prindërit, duhet të kenë koordinim të përhershëm lidhur me nevojat e fëmijëve dhe zbatimin të aktiviteteve e taktikave, përmes së cilave nxitet përparimi verbal i fëmijëve. Në këtë mënyrë të dy partnerët ia lehtësojnë punën vetes, ndajnë përgjegjësitë e angazhimit dhe sjellin rezultate të fëmijët.

Sipas Fellowes & Oakley (2020), si strategji për prindërit dhe edukatorët që të mbështetësin fëmijët në aspekt të gjuhës dhe komunikimit, mund të jenë:

- “Bëhuni model i mirë/pozitiv i fëmijëve: lexojuni atyre përralla, tregime dhe ngjarje të përshtatshme;
- Këndoni bashkë me ta, sqaroni e diskutoni fjalët dhe kuptimin e këngës;
- Bëni sa më shumë pyetje, nxisni dilema që kërkojnë të shprehurit e fëmijëve, përsërisni fjalët bashkë me fëmijët;
- Trajtoni pyetjet e fëmijëve dhe inkurajoni të pyesin edhe ata;

- Lavdëroni dhe motivoni të dëgjuarit dhe të folurit e tyre, përfillni dëshirat dhe idetë e tyre;
- Modifikojeni dhe përshtateni leksikun dhe gjuhën tuaj me të fëmijëve;
- Flisni e diskutoni sa më shumë me ta, për gjithçka që i rrethon dhe me të cilat ballafaqohen, përgjatë përditshmërisë në shtëpi e në institucion, si: duke ngrënë, diskutim rreth ushqimit, duke luajtur, diskutim rreth lojës, duke bërë aktivitetet në art, diskutim rreth ngjyrave, dhe diskutim rreth gjithçkaje që e bëjnë dhe e përjetojnë” (Fellows & Oakley, 2020).

**2.3. Qëllimi** Qëllimi i këtij kapitulli të hulumtimit ishte të shqyrtojë rëndësinë e bashkëpunimit edukatore-prind, në funksion të qasjes së duhur ndaj fëmijëve me ngecje në të folur dhe të identifikojë mënyrën e bashkëpunimit edukatore-prind në mbështetje të kësaj problematike.

**2.3.1. Pyetjet hulumtuese**

- Si e shohin prindërit rolin e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve të tyre me vështirësi në të folur?
- Cilat janë mënyrat e bashkëpunimit të edukatores me prindërit lidhur me zhvillimin e komunikimit verbal të fëmijëve parashkollorë me vështirësi në të folur?

**2.4. Metodologjia**

Për mbledhjen e të dhënave nga terreni, kemi zbatuar metodën cilësore, kurse përmes intervistave gjysmë të strukturuar kemi mbledhur rrëfimet e respondentëve të përcaktuar për mostër, e të cilët janë të komunitetit prindër dhe edukatore.

**Mostra** Mostra është e qëllimshme. Për pjesën e bashkëpunimit me prindër janë intervistuar 22 respondentë (12 edukatore dhe 10 prindër, të fëmijëve me vështirësi në të folur).

**Instrumentet** Janë hartuar intervista gjysmë të strukturuar, për edukatore dhe për prindër, përmes së cilave janë mbledhur të dhënat për qëndrimet e prindërve dhe edukatoreve nga perspektiva e tyre, lidhur me vështirësitë e fëmijëve në komunikim verbal, në identifikimin me kohë të tyre, dhe në shkëmbimin reciprok të informatave për përparimin e fëmijëve në institucionet parashkollore.

**Procedura e mbledhjes së të dhënave** Instrumentet fillimisht janë pilotuar në një kopsht publik dhe në një kopsht privat, për të vazhduar me plotësimet e nevojshme në instrumentet e hulumtimit.

Në fillim janë kontaktuar drejtoreshat e institucioneve parashkollore, janë njoftuar për hulumtimin dhe për mostrën që do të jetë e përfshirë në hulumtim. Ato u zotuan se do t'i njoftojnë prindërit e fëmijëve të jenë në kopsht në ditët e caktuara, kur edhe realizohet hulumtimi. Në disa raste u kontaktuan nga vetë drejtoreshat e institucioneve, e në disa raste nga kopshti janë siguruar kontaktet dhe hulumtuesja i ka kontaktuar edukatoret dhe prindërit dhe është organizuar realizimi i intervistës.

**Analiza dhe interpretimi** Të dhënat e mbledhura janë grupuar në kategori tematike që lidhen me pyetjet kërkimore, në një strukturë të temave që e karakterizojnë këtë hulumtim. Nga interpretimi fillestar i të dhënave është realizuar përshkrimi përmbledhës, duke i paraqitur në raport



përshkrues për secilën pyetje dhe nënpyetje të intervistës. Janë nxjerrë konkluzionet dhe janë paraqitur rekomandimet sipas përgjegjësisë që kanë, duke filluar nga edukatorja, prindi e deri te niveli qendror institucional.

**2.5. Rezultatet e  
Rezultatet e  
hulumtimit** Rezultatet përfaqësojnë mostrën e përzgjedhur dhe nuk i përgjithësojnë rastet në nivel vendi. Duke marrë për bazë mostrën e përfshirë, problematikën e trajtuar në këtë studim dhe gjendjen në terren, kemi këto rezultate:

**2.5.1. Karakteristikat  
e pjesë  
marrësve -  
respondentëve  
e (prindër dhe  
edukatore)** Të gjithë pjesëmarrësit pohuan se i kushtojnë rëndësi të madhe rolit të tyre në rritjen e kapaciteteve gjuhësore të fëmijëve dhe aftësive për komunikim e informim, si dhe raportuan një sërë praktikash, të cilat mund të ndikojnë në avancimin e të folurit të fëmijëve. Por, ata rrallë i referoheshin përdorimit të ndonjë strategjie konkrete, për përfundimin e të folurit dhe zgjerimin e leksikut të fëmijëve. Pohonin se nuk ndiheshin të sigurt në aftësinë dhe suksesin e tyre për të identifikuar mirë dhe për të ndihmuar fëmijët në të shprehurit gojor, si prindërit në shtëpi, ashtu edhe edukatorët në institucione, të cilat shprehen se, përgjatë kualifikimit të tyre, nuk kishin marrë informacione të duhura lidhur me këtë problem, për të cilin edhe kërkonin trajnime specifike. “Pavarësisht se edukatorët kanë rol parësor, prindërit kanë gjasa dy herë më shumë sesa edukatorët të identifikojnë më me saktësi çështjen e zhvillimit të gjuhës së fëmijëve” (Christopoulos & Kean, 2020).

Vështirësitë në të folur te fëmijët e këtyre prindërve ishin të këtyre kategorive: Fëmijë që flasin fare pak, pa pasur ndonjë problem apo diagnozë tjetër; fëmijë që flasin vetëm gjuhën angleze; fëmijë që flasin të dy

gjuhët nga pak, por nuk kanë kapacitete të duhura leksikore e komunikuese në asnjërën gjuhë, në raport me moshën që kanë.

**2.5.2. Të dhënat nga perspektiva e prindërve**

Prindërit kanë folur hapur për shqetësimet e tyre, për shkak të ngecjeve të fëmijëve në komunikim. Ata në detaje treguan se si fëmijët e tyre qëndrojnë në shtëpi të paimterësuar për komunikim dhe bisedë, zakonisht nuk bëjnë pyetje dhe nuk kanë kërkesa për ndonjë sqarim. Atyre u mjafton një mjet teknologjik dhe nuk bëhen të gjallë. Edhe nëse u merren, ata nuk kanë interesim për lojë dhe as për ndonjë tjetër preokupim. Në mungesë të aparatit digjital, prindërit thonë se fëmijët bëhen më nevrinë, më agresivë, dhe insistojnë me këmbëngulje që t'u jepen. Shqetësimet e përgjithshme të prindërve ishin kryesisht të kësaj natyre: mosprania e tyre (prindërve) gjatë ditës në shtëpi; mungesa e bashkëbisedimit me fëmijë; krijimi i prirjeve asociale të fëmijëve dhe rritja e dëshirës së tyre për t'u tërhequr në vetmi. Kurse shqetësimi më i madh i prindërve ishte bindja se fëmijët e tyre nuk ishin mirë, edhe pse shumicën e tyre edukatorët i kishin qetësuar, duke iu argumentuar se fëmijët e tyre nuk kishin simptoma të tjera serioze, përveç ngecjes në të folur, si pasojë e moskomunikimit të fëmijës me të tjerët në shtëpi. Kishte përvoja të shumta përgjatë shërbimit të edukatoreve, se fëmijët vetëm me ngecje në të folur e pa probleme të tjera, fizike e fiziologjike, zakonisht në institucion, në bashkëveprim e komunikim me fëmijë të tjerë, shumë shpejt e pasurojnë fjalorin dhe bëhen më komunikues. Kurse dy nëna (nga 10 gjithsej) ishin më pak të shqetësuara, për shkak të mungesës së njohurive që kishin lidhur me kapacitetet gjuhësore të fëmijëve, krahas moshës. Dy nëna të tjera, që i kishin fëmijët me ngecje, si fëmijë të dytë ose të tretë,

shqetësoheshin më shumë, sepse e krahasonin me fëmijën paraparak dhe e shihnin që ky tjetri ka ngecur më shumë.

Disa prindër theksuan se prej momentit që kanë filluar të bashkëbisedojnë e të bashkëpunojnë më shumë për këtë problem me edukatoren, janë më të qetësuar e më të lehtësuar për ngecjen e fëmijëve të tyre. Ndërkaq, ngurrimi i prindërve për të ngritur shqetësimet me edukatoren mund të ketë implikime në identifikim të vonshëm të fëmijës me ngecje në komunikim dhe vonesë në mbështetjen e nevojshme të atyre me vështirësi të kësaj natyre. Kjo mund të rezultojë me humbje të mundësisë për ndërhyrje të hershme dhe arritje të rezultateve të dëshiruara.

**- Komunikim i hapur prind- edukatore, informacione më të plota lidhur me ngecjen e fëmijëve**

Shumica e prindërve reflektuan pozitivisht dhe kanë potencuar se kanë komunikim të mirë me edukatoren, por shumica e tyre (7 nga 10 prindër) nuk janë shprehur për ndonjë komunikim më specifik rreth nivelit të problemit të fëmijëve, vlerësimin apo ndikimin të ndonjë alternative të zbatuar, me fokus të posaçëm avancimin e tyre në komunikim. Kurse një nënë thotë: “As që i intereson edukatoren për djalin tim. Me të merret vetëm asistentja, me të cilën edhe kam bashkëpunim të lirshëm e të afërt”.

**- Përkushtimi i prindërve ndaj vështirësive të fëmijëve në të folur**

Gjashtë nga dhjetë nënat kanë thënë se janë krejt kohën me fëmijët në shtëpi, pasi që nuk punojnë (disa sepse nuk kanë nevojë, e disa sepse nuk kanë mundësi punësimi) dhe vazhdimisht janë në shtëpi pranë tij, por thonë se fëmijët pak janë të interesuar të qëndrojnë afër tyre, më shumë preferojnë të shohin televizorin dhe të eksplorojnë në telefon. Asnjëra nga këto nuk potencon që përderisa janë me

fëmijët në shtëpi përpiqen të luajnë me ta, të eksperimentojnë e të komunikojnë gjatë ditës, në vazhdimësi, për gjithçka nëpër të cilën kalojnë në përditshmëri. Asnjëra nuk tregoi se insiston të këmbëngulë, në nxitje të të shprehurit të fëmijëve, duke u bërë pyetje, duke u kërkuar sqarime, apo edhe duke e shoqëruar më shumë përgjatë prezencës së tyre në shtëpi.

- **Marrja e sugjerimeve për mbështetje në shtëpi nga ana e edukatoreve dhe ndikimi i tyre në qasjen e prindërve ndaj vështirësive të fëmijëve**

Asnjëra nga nënat nuk argumentojnë ndonjë propozim a sugjerim me fokus në përmirësimin e nevojave të fëmijëve për ngritje të kapaciteteve gjuhësore. Njëra potencon që asistentja u jep sugjerime, por nuk e konkretizon më tutje me ndonjë detaj, por thotë se ajo që ka ndikuar në mënyrë të efektshme në komunikimin me fëmijë është se me bashkëshortin para fëmijës nuk e përdorim telefonin, gjë që edhe e mbajnë larg nga fëmija dhe në këtë mënyrë edhe krijojnë mundësi më të mëdha për biseda me të.

- **Sa janë prindërit të kënaqur me qasjen individuale të edukatoreve ndaj fëmijëve me vështirësi në të folur?**

Dy nga dhjetë prindërit tregojnë se e informojnë edukatoren në mënyrë të detajuar për ato që bëjnë me fëmijët në shtëpi, për nivelin e përmirësimit, për fjalët e reja që fëmijët i mësojnë çdo ditë dhe sa e zgjerojnë leksikun, për gatishmërinë dhe interesimin më të madh të fëmijës për komunikim. Por edukatoren i paraqesin si të paimteresuara sa duhet, edhe për komunikim me to, rreth përparimit të fëmijës në të folur. Sipas tyre, edukatoren nuk kanë qasje individuale ndaj fëmijëve të tyre, me arsyetimin se nuk kanë kohë as mundësi ta bëjnë këtë, për shkak të numrit të madh të fëmijëve. Njëra nga nënat thotë se është shumë e kënaqur me edukatoren dhe trajtimin që ajo ia bën fëmijës së saj, ka

treguar afërsi në komunikimin me fëmijën dhe e ka socializuar me fëmijët e tjerë, gjë që ka bërë që fëmija të ndihet më i sigurt, më me vetëbesim. Ajo potencon se socializimi me fëmijët ka ndikuar në bashkëbisedim të fëmijës me shokët dhe përparimin në të shprehur. Një fakt i tillë bën të konfirmohet ndikimi i gjendjes socio-emocionale të fëmijëve, në kapacitetet e tyre gjuhësore.

- **Koordinimi prind- edukatore në përkushtimin ndaj zhvillimit gjuhësor të fëmijëve, në mënyrë që të plotësojnë njëri-tjetrin** Lidhur me këtë, njëri nga prindërit thotë se koordinohen, por shumë rrallë, kurse të gjithë prindërit kanë thënë se nuk kanë ndërmarrë asnjëherë ndonjë aktivitet në mënyrë vazhdueshme e të koordinuar me edukatoren. Kjo, siç shihet, është një mangësi thelbësore e qasjes, bashkëpunimit të të dy palëve, sepse me insistimin e njërit nga partnerët është gjë e realizueshme dhe shumë e suksesshme në raport me nevojat apo ngecjet e fëmijëve.

- **Çka do të ndryshonit në punën e edukatores lidhur me angazhimin e saj, rreth problemit të fëmijës tuaj?** Në këtë pyetje, katër prej dhjetë prindërve janë përgjigjur se nuk kanë nevojë të përzihen në punën e edukatores, sepse ajo është e kualifikuar dhe i di metodat e teknikat e veta të sjelljes me fëmijë. Katër prindër ishin deri diku të kënaqur dhe nuk ishin për shumë ndryshime të edukatorja, përveçqë do t'i preferonin më shumë afërsi dhe butësi në komunikim me fëmijët. Dy të tjerë ishin krejtësisht të pakënaqur dhe u shprehën se do të ndryshonin gjithçka në qasjen e edukatores ndaj fëmijëve, duke filluar nga komunikimi i saj me fëmijët, zbatimi i trajtimit individual të fëmijëve, gjithëpërfshirja, vlerësimi dhe interesimi i saj për bashkëpunim me prindër, sipas nevojave të paraqitura.

- Çfarë mendoni se e shkakton ngecjen në të folur?

Të gjithë prindërit kishin mendime pothuajse të njëjta lidhur me faktorët që ndikojnë në ngecje të fëmijëve në aspektin gjuhësor. Si kryesore e potencuan teknologjinë, e cila, sipas tyre, po ndikon që fëmijët të mësojnë gjuhën angleze para gjuhës shqipe. Kjo (gjithnjë sipas tyre) po ndikon që fëmijët të izoloohen e të bëhen më të tërhequr, më asocialë. Pastaj, tre nga prindërit fajësuan edhe edukatoren për qasjen joadekuate ndaj zhvillimit gjuhësor të fëmijëve. Kurse, asnjë nga prindërit nuk ishin objektivë, të potenconin faktin që vetë prindërit janë kompetentët e parë dhe e kanë përgjegjësinë më të madhe për stimulimin e aftësive komunikuese dhe zhvillimin e tërësishëm të fëmijëve të tyre. Vetëm një nga dhjetë prindërit theksoi se bën përpjekje të flasë me fëmijën dhe përpiqet të nxisë diskutimin dhe reflektimin verbal me të, përgjatë gjithë kohës që është në shtëpi. Njëkohësisht, ata pohuan se përpiqen edhe të largojë fëmijët nga aparatet teknologjike, të cilat po lënë pasoja edhe në komunikim, në socializim dhe në karakterin e fëmijëve, sepse atyre po u shfaqen edhe elemente autike apo të fëmijëve intraversë.

2.5.3. Të dhënat nga perspektiva e edukatoreve

Të dhënat e mëposhtme janë reflektim i edukatoreve të intervistuar lidhur me këto specifika të çështjes studimore.

- Sa është i hapur dhe me informacione më të detajuara bashkëpunimi i edukatoreve me prindërit e

Sipas 12 edukatoreve, në përgjithësi, komunikimi edukator-prind nuk është i kënaqshëm as i duhur. Për këtë relacion, ankesa kanë paraqitur më shumë edukatorët sesa prindërit. Vetëm pesë nga dymbëdhjetë edukatorët kanë thënë se me prindërit që i kanë fëmijët me ngecje në të folur kanë bashkëpunim më specifik dhe komunikim më të shpeshtë e më

**fëmijëve me  
vështirësi në  
të folur?**

detajuar sesa me prindërit e tjerë. Kurse 7 nga 12 edukatorët kanë thënë se bashkëpunimi me prindër në përgjithësi dhe me prindër të këtyre fëmijëve në veçanti është jopërmbytësor dhe shumë formal. Disa nga to potencuan se kanë prindër të fëmijëve me ngecje, që komunikojnë me rezerva dhe janë refuzues, nuk i pranojnë faktet dhe nevojat reale të fëmijëve të tyre. Po ashtu, edukatorët potencuan se disa nga prindërit edhe hezitojnë të pranojnë informata në detaje për ngecjet dhe nevojat e fëmijëve të tyre dhe nuk e kanë interesimin e nevojshëm për tejkalimin e atyre problemeve. Këso rastesh ndodhin me prindër që janë më pak të arsimuar, më pak të informuar e më pak të vetëdijshëm për seriozitetin e mangësive në të shprehur verbal dhe për rëndësinë që kanë gjuha dhe komunikimi për zhvillimin e gjithanshëm dhe të ardhmen e fëmijëve. Katër nga edukatorët thanë: “Ne, në institucion, po bëjmë shumë përpjekje për të ndihmuar fëmijët në aspektin gjuhësor, por nuk e kemi mbështetjen e prindërve. Ata nuk na informojnë për nivelin e komunikimit të fëmijëve në shtëpi dhe përpjekja jonë nuk po ka sa duhet efekt, sepse po ka shikëputje e jo vazhdimësi të stimulimit të tij për të folur”. Po ashtu, sipas disa edukatoreve, ka edhe prindër që mosinteresimin e tyre për fëmijët që nuk flasin, edhe pse janë të moshës 3 - 4 vjeç, e arsyetojnë duke thënë që “fëmija im ka vonesë në të folur, por është ende herët, ka ende kohë për të folur”.

**- Si bëhet  
identifikimi i  
fëmijëve me  
vështirësi në  
të folur?**

Lidhur me identifikimin e fëmijëve me ngecje në të shprehur dhe komunikim, shumica e edukatoreve potencuan se ka raste që prindi, porsa e regjistron fëmijën në institucion, që në fillim, na tregon se ai ka vërejtur mosinteresimin e fëmijës së tij për të komunikuar apo edhe mangësi gjuhësore. Pastaj, ka raste kur prindi thekson edhe se arsyeja e sjelljes së

fëmijës në institucion (edhe pse ka kush kujdeset për të në shtëpi) është mundësia më e madhe e zhvillimit të potencialit gjuhësor të fëmijës, përmes socializimit me moshatarët, bashkëveprimeve në lojëra e aktivitete, dhe bisedës e diskutimeve për gjërat me të cilat preokupohen gjatë ditës.

Në rastet kur identifikimin e këtyre fëmijëve e bëjnë edukatorët, tri, nga dymbëdhjetë prej tyre, shpjeguan se ka raste kur fëmija vërehet që nga momentet e para në institucion, sepse është i heshtur, nuk reflekton gatishmëri për afërsi me të tjerët dhe as komunikim, por ka raste që mund t'i identifikojmë vetëm përgjatë vëzhgimit apo vlerësimit të aktiviteteve të ndryshme të natyrës gjuhësore (lexim i përrallave, komentim, pyetje e diskutim), pasi duke i krahasuar me të tjerët ata vërehen se janë jokomunikues dhe të tërhequr.

Po ashtu, edukatorët potencuan se kanë shumë raste që prindërit në mëngjes vetëm i lenë fëmijët dhe pasdite, shpejt e shpejt, i marrin nga institucioni dhe sado që ne me fakte përqipemi t'i ndalim e të diskutojmë rreth kapaciteteve të ulëta gjuhësore të fëmijëve të tyre, krahas shokëve të tjerë, ata rezistojnë ta pranojnë si të vërtetë këtë problem, nga pavetëdija, mungesa e informimit për problemin, apo ndoshta edhe nga mentaliteti i tyre dhe kompleksët.

- **Cila është qasja individuale e edukatoreve ndaj fëmijëve me vështirësi në të folur?**

Qasja individuale ndaj fëmijëve në përgjithësi është edhe parim i edukimit në fëmijërinë e hershme, por është domosdoshmëri në raste kur fëmijët kanë ndonjë nevojë, kanë mbetur prapa në çfarëdo aspekti, apo edhe kur fëmijët kanë vështirësi në komunikimin verbal. Megjithatë, jo secili fëmijë i institucioneve tona parashkollore ka trajtim individual edhe atëherë kur ai ka shumë nevojë për mbështetje. Kështu që, në këtë



pyetje, një edukatore thotë se nuk u qasen këtyre fëmijëve individualisht, sepse nuk kanë mundësi, por përpiqen ta angazhojnë e ta përfshijnë sa më shumë në aktivitete me fëmijët e tjerë dhe të aktivizohen edhe në lojë dhe në bashkëbisedim. Kurse, 8 nga 12 edukatoret kanë pohuar se nuk mund t'u përkushtohen në mënyrë individuale fëmijëve me ngecje në të folur, për shkak të mundësive të limituara dhe ngarkesave të shumta, sepse kanë numër të madh të fëmijëve në grup (në shumë raste edhe mbi 25 fëmijë). Kurse, 3 nga to kanë thënë se bëjnë përpjekje për qasje individuale ndaj fëmijëve me nevoja specifike, sepse u krijohet mundësia, pasi e kanë edhe një asistente në grup. Njëra nga edukatoret, duke menduar se edhe për fëmijët që nuk kanë probleme fiziologjike në të folur dhe nuk janë me aftësi të kufizuara, as me probleme në shqiptim, por vetëm kanë leksik të kufizuar në të shprehur apo edhe prirje për të folur vetëm në gjuhën angleze, mendojnë se për qasje adekuate ndaj këtyre fëmijëve duhet kualifikim i veçantë profesional: "...unë nuk jam profesioniste e logopedisë, nuk jam e informuar dhe nuk di t'i mbështes në këtë aspekt", shprehet një edukatore.

- **Këmbimi i sugjerimeve reciproke lidhur me ngecjet e fëmijëve në të folur dhe nivelin e përparimit gjuhësor të tyre në institucion dhe në shtëpi**

Për këmbimin e përvojave, konsultimeve dhe sugjerimeve me prindërit e fëmijëve me ngecje në komunikim, edukatoret u shprehën se e kanë shumë të limituar, për shkak të disa arsyeve, ndër të cilat më evidente janë këto: Për shkak se disa prindër janë refuzues dhe nuk e pranojnë gjendjen reale të fëmijëve të tyre. Për shkak se disa prindër të tjerë vazhdimisht pohojnë se fëmijën e kanë në rregull, por mund të ketë vetëm ndonjë vonesë në të folur, gjë e cila (sipas tyre) me kohë do të normalizohet. Për shkak të disa të tjerëve, që janë fare të papërshtatshëm në komunikim

dhe assesi nuk pranojnë konsulta, me pretendimin se e dinë vetë se çka duhet të bëjnë me fëmijët e tyre. Kurse, disa prindër të tjerë janë krejtësisht të painformuar lidhur me problemin e fëmijëve të tyre, për mënyrat se si mund të mbështesin dhe stimulojnë të shprehurit e tyre, por këta më lehtësisht i pranojnë këshillat dhe sugjerimet tona, se si duhet t'u qasen atyre në shtëpi, në mënyrë që të nxisin fëmijët të shprehen e të pyesin, të përgjigjen, apo të diskutojë lidhur me realitetin e tyre të përditshëm. Ngjashëm pohojnë shumica e edukatoreve lidhur me koordinimin edukatore-prind, rreth nevojave për mbështetje të fëmijëve me ngurrim apo me ngecje në të folur. Kurse, katra, ndër dymbëdhjetë edukatore, pohojnë se komunikimi reciprok me prindërit më së shumti varet nga niveli i edukimit dhe kulturës së prindërve, nga botëkuptimi dhe mënyra e jetesës së tyre, dhe shpesh edhe nga insistimi i tyre për trajtim tradicional të problemit.

- Çfarë mendoni se ndikon në ngecjet e kapaciteteve të fëmijëve në të folur?

Lidhur me shkaktarët e ngecjeve të zhvillimit gjuhësor në fëmijërinë e hershme, te fëmijët që nuk kanë asnjë lloj problemi apo diagnoze, përveç kapaciteteve të kufizuara për të shprehur e komunikim, pothuajse të gjitha edukoret e intervistuar kanë mendim përafërsisht të ngjashëm. Ato potencojnë se fëmijët nuk kanë si të aftësohen në të shprehurit verbal në shtëpi, sepse prindërit kalojnë pak kohë me ta, flasin dhe debatojnë lidhur me mjedisin që i rrethon në jetën e përditshme në familje. Ata nuk janë të ndërgjegjshëm për faktin që fëmija nuk ka si të mësojë fjalë pa i dëgjuar të tjerët rreth tij, duke biseduar ndërmjet vete ose duke iu drejtuar vetë fëmijëve. Po ashtu, sipas shumicës së edukatoreve, prindërit, shumë shpesh, i „rehatojnë” fëmijët dhe i “qetësojnë” kërkesat e pakënaqësitë e tyre duke ua lënë në dispozicion telefonin apo mjetet tjera

digjitale, përmes së cilave fëmija krijon shumë shpejt shkathtësi të përdorimit të tyre, mëson terma të gjuhës angleze (zakonisht terma të botës e natyrës së fëmijëve përmes lojërave që ata i aplikojnë e i shohin aty dhe shumë shpejt hipnotizohen nga ato aparate dhe krijojnë varësi ndaj tyre. Si rezultat i kësaj, fëmijëve në moshën e tyre optimale për përvetësim të gjuhës amtare (shqip) u ofrohet dhe u mundësohet leksiku i gjuhës angleze.

Të rriturit përreth fëmijës i flasin shqip (familja dhe edukatorja), por shumë pak, krahas gjuhës angleze, që ia ofron aparati krejt kohën, sa është duke e shikuar televizor apo duke luajtur me të (telefon, Ipad etj.) dhe atë në mënyrë shumë atraktive e argëtuese për moshën e tyre. Kështu që fëmija i vogël, i familjarizuar tërë ditën me gjuhën angleze përmes aparateve dhe njëkohësisht me mungesën e ofrimit dhe dëgjimit të gjuhës shqipe nga familjarët, mbetet në mes të dilemave dhe një konfuzioni gjuhësor. Njëra nga edukatorët shprehet: “Në këso gjendjesh na vijnë shpesh fëmijët dhe po kemi vështirësi në mirëkuptim e në komunikim me ta. Prandaj, po duhet të bëjmë përpjekje të mbështetjes shtesë me ta, jashtë planeve e obligimeve tona. Numri i këtyre fëmijëve po na shtohet përditë dhe ky është një fenomen shqetësues për ne, për familjen, e cila është përgjegjësjë kryesore për këto raste. Meqenëse tashmë këto raste janë përditshmëri jona në institucionet parashkollore, ne kemi nevojë për trajnime profesionale specifike, për identifikim, mbështetje dhe avancim gjuhësor të fëmijëve.

Thënë përfundimisht, sipas shumicës së edukatoreve të përfshira në hulumtim, përgjegjësit kryesorë të mangësive gjuhësore të fëmijëve (me përjashtim të fëmijëve me diagnoza të lindura), janë prindërit/familja,

pasi po shmanget bashkëbisedimi me fëmijët për arsye të ndryshme. Mirëpo, edhe institucioni e ka një pjesë të përgjegjësisë, në mbështetje dhe avancim të aftësive gjuhësore të fëmijëve, duke krijuar mjedis atraktiv për lojë, socializim e bashkëbisedim, duke shtruar pyetje, dilema, mundësi dhe kërkesa të të shprehurit të fëmijëve, duke përzgjedhur strategji alternative për stimulim të komunikimit dhe zgjerim të leksikut të gjuhës shqipe. “Krijimi i rrethanave komunikuese në shtëpi dhe zbatimi i strategjive stimuluese nga ana e edukatores në institucionin parashkollor patjetër që sjell rezultate të ngritja e kapaciteteve komunikues të fëmijët”, thotë njëra nga edukatoret e intervistuar, e cila ka shumë përvoja me fëmijë të tillë.

- **Opinion i edukatoreve rreth bashkëpunimit me prindër**

Pjesa më e madhe e edukatoreve shprehen se bashkëpunimi me prindër është pjesë rutinë dhe domosdoshmëri e punës në institucion dhe takohen çdo ditë, përgjatë pranim-dorëzimit, por nuk kanë ndonjë komunikim shumë përmbajtësor me ta, sepse ata zakonisht janë të lodhur nga puna ose thonë se nuk kanë kohë të zgjasin bisedën. Kurse takimet mujore ose periodike i janë më përmbajtësore dhe me të gjithë prindërit. Ndërkaq, disa edukatore potencuan se takimet me prindër janë të domosdoshme, po ashtu këmbimi i informatave rreth fëmijës dhe pjesëmarrja sa më e madhe e prindërve në institucion e lehtëson punën e tyre dhe ndikon shumë në cilësinë e shërbimit ndaj fëmijëve, të cilët nga prania më e shpeshtë e prindërve në institucion ndihen më të sigurt dhe më me vetëbesim.

### 3. Konkluzione

Sipas të dhënave të hulumtimit, rezulton se në institucionet tona parashkollore përditë e më shumë është i pranishëm dhe shtohet numri i fëmijëve me vështirësi në të folur, zhvillim të dobët të aftësive komunikuese me të tjerët dhe me elemente të krijimit të një personaliteti të tërhequr e të shmangur nga shoqëria. Këtë e pohuan shumica e edukatoreve (ku janë realizuar instrumentet e hulumtimit), duke shprehur brengën dhe shqetësimet e tyre, për faktin se sa shumë fëmijë janë asocialë dhe me mangësi e vështirësi në të shprehurit verbal. Në përgjithësi, edukatoret e intervistuar shprehën pakënaqësi për mosgatishmërinë e duhur të prindërve për mbështetje dhe trajtim të duhur të këtij problemi të fëmijëve. Kurse, sipas reflektimit të tyre, prindërit ishin më pak të shqetësuar lidhur me këtë problem zhvillimor të fëmijëve. Prindërit, po ashtu, nuk ishin të pakënaqur as me bashkëpunimin, komunikimin dhe konsultimet e këmbëzera me edukatoren, megjithëse (sipas edukatoreve), në disa raste, kjo ndodhte shumë me vonesë, për shkak të hezitimeve dhe komplekseve të prindërve për të pranuar problemin e fëmijëve të tyre.

Në përgjithësi, të dhënat e këtij studimi reflektojnë, për faktin se pjesëmarrësit tanë (prindër dhe edukatore) nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur rolit të tyre në zhvillimin gjuhësor të fëmijëve. Sipas këtyre të dhënave, shumë edukatore dhe prindër konsiderojnë se nuk kanë vetëbesim dhe njohuri të mjaftueshme për ndikim në zhvillimin e gjuhës dhe për identifikimin e hershëm të fëmijëve në rrezik për ngecje të mëtutjeshme gjuhësore. Gjetjet tona paraqesin edhe kërkesën e edukatoreve për avancim profesional specifik për përkrahje dhe identifikim të fëmijëve me

aftësi gjuhësore jo adekuate për moshën. Megjithëkëtë, të rralla janë të evidentuara pohimet e partnerëve (edukatore-prind) se realizojnë komunikim të afërt, konsultativ dhe të koordinuar reciprokisht, për trajtim të nevojave gjuhësore të fëmijëve.

Duke u bazuar në bisedat me respondentët e përzgjedhur si mostër, mund të konfirmojmë se edukatoren dhe prindërit nuk e kanë parasysh shëndetin shoqëror dhe emocional të fëmijëve, përmes të cilit krijohen marrëdhënie besimi dhe respekti me fëmijën. Po ashtu, krijohen mundësi më të mëdha të bashkëpunimit dhe bashkëbisedimit, si dhe ofrohen mundësi për diskutime dhe të shprehur të fëmijëve. Shumë e prindërve pohuan se nguronin të shprehnin shqetësimin e tyre për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve, pasi ata vetë nuk ishin të sigurt se shqetësimi i tyre ishte i nevojshëm dhe kishin dilemën se ndoshta vështirësitë gjuhësore të fëmijëve do të zgjidheshin natyrshëm, me kohë. Në këtë aspekt, prindërit, por edhe disa edukatore, ndiheshin pa informacione të nevojshme për të ndërmarrë diçka më adekuate.

Në përgjithësi, ky studim ofron një pasqyrë reale për rëndësinë e bashkëpunimit edukatore-prind, të shqyrtuar nga të dy këndvështrimet e tyre, lidhur me vështirësitë, ngecjet e fëmijëve në gjuhë e komunikim dhe mundësitë për mbështetje të tyre. Intervistat, në përgjithësi, zbuluan se prindërit dhe një pjesë e edukatoreve kishin një mirëkuptim, por nuk kishin shumë njohuri specifike lidhur me strategjitë e mundshme, zbatimi i së cilave do të stimulonte/avanconte kapacitetet gjuhësore.

## PËRFUNDIM

Hulumtimi trajton dy kapituj, të cilët kanë një qëllim të përbashkët: rolin e edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët 3-6 vjeç, të cilët kanë vështirësi në të folur. Bazuar në rezultatet e hulumtimit, vlerësohet shumë e nevojshme të ndërmerren hapa për sensibilizim, mobilizim, qasje të drejtë, angazhim, planifikim dhe realizim të shumë aktiviteteve për të trajtuar si duhet këtë çështje. Të fillohet nga shkaqet pse e kemi këtë gjendje në institucionet tona parashkollore (këtë numër të fëmijëve me vështirësi në të folur) dhe për të vazhduar pastaj se si mund të kemi të rritur (prindër, edukatore, profesionistë, asistente etj.), të përgatitur që t'i qasen drejt zhvillimit të komunikimit verbal të fëmijëve, konkretisht atyre që kanë vështirësi në të folur. Hulumtimi ka trajtuar rolin e edukatores dhe prindit në një mostër të caktuar dhe konsiderohet se ka nevojë për identifikim me kohë të këtyre vështirësive te fëmijët, për vlerësim dhe trajtim.

Rezultatet tregojnë se edukatoret kanë nevojë për më shumë profesionalizëm për të zhvilluar komunikimin verbal te fëmijët që kanë vështirësi në të folur. Është e nevojshme të zhvillohen kapacitetet e edukatoreve, për zbatim të strategjive adekuate, për krijim të mjedisit nxitës për zhvillim të të folurit te fëmijët, për bashkëpunim me prindërit dhe profesionistët, për të mbështetur fëmijët që kanë vështirësi në komunikimin verbal. Zhvillimi profesional i edukatoreve në këtë aspekt ndihmon edhe në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët në grupmoshat 3-6 vjeç, duke përshtatur qasjen dhe aktivitetet e tyre në mënyrë të përshtatshme për nevojat e secilit fëmijë.

Gjetjet paraqesin nevojën që prindërit t'i qasen drejt zhvillimit të të folurit të fëmijëve të tyre, sepse shumica

e prindërve nuk e marrin shqetësuese nëse fëmija i tyre ka vështirësi në komunikim verbal dhe nuk i trajtojnë me kohë dhe në mënyrë adekuate këto vështirësi.

Paraqitet nevojë urgjente që këta fëmijë të trajtohen, sepse zhvillimi i komunikimit verbal është faktor kryesor në zhvillimin e mëtutjeshëm të tyre, për shkollë dhe për jetë.

Është e nevojshme të realizohen hulumtime të tjera për shkaqet pse e kemi këtë gjendje, për funksionimin e institucioneve tona parashkollore, publike e private, krahas krijimit të mekanizmave mbështetës që trajtojnë si duhet fëmijët me vështirësi në të folur, marrë parasysh se nevojat për një trajtim adekuat të kësaj çështje po rriten dita-ditës.

## REKOMANDIME

Në secilin kapitull janë nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet që u përkasin kapitujve dhe tani janë paraqitur rekomandime për institucionet dhe aktorët përgjegjës:

### Rekomandime për MASHTI-n

1. Të monitorohet zbatimi i Udhëzimit Administrativ për punën e ekipit komunal të vlerësimit për fëmijët me nevoja të veçanta, që të bëhet vlerësimi i fëmijëve dhe në rastet kur vlerësohen si fëmijë që kanë nevojë për mbështetje specifike të ndërmerren hapa për të ofruar mbështetje;
2. Të monitorohet zbatimi i dokumenteve zyrtare sa i përket zhvillimit të komunikimit verbal të fëmijëve, sepse në dokumente janë të rregulluara, por praktika po tregon se nuk zbatohen si duhet;



3. Të realizohet zhvillimi profesional krahas nevojave që kanë edukatorët në punën e tyre me fëmijët, sidomos në ngritje të kapaciteteve për përdorim të strategjive të nevojshme për punë me fëmijë që kanë vështirësi në të folur;
4. Të krijohen mekanizma që mbështesin institucionet publike dhe private parashkollore, për të realizuar mbështetje profesionale (psikolog, logoped etj.), që të bëhet vlerësimi i fëmijëve me kohë për vështirësitë e tyre në zhvillim, me theks të veçantë në zhvillimin e të folurit.

#### Rekomandime për DKA-n

1. Të bëhen funksionale ekipet për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta - në kuadër të komunave, për mbështetje në identifikimin dhe vlerësimin e rasteve për fëmijët që kanë vështirësi në të folur;
2. Të mbështeten kapacitetet profesionale të edukatoreve për trajtimin e fëmijëve në të gjitha aspektet zhvillimore, sipas nevojave individuale të tyre, veçanërisht për zhvillimin e komunikimit verbal.

#### Rekomandime për menaxhmentin e institucionit parashkollor

1. Të kërkohet nga prindërit që të japin informata në detaje për zhvillimin, vështirësitë e nevojat eventuale të fëmijëve, në mënyrë që t'u ndihmohet me kohë;
2. Të zbatohet monitorimi për identifikim të kapaciteteve profesionale të edukatoreve dhe të angazhohet staf profesional, krahas nevojave profesionale të edukatoreve dhe të fëmijëve;

3. Të kërkohet bashkëpunim i ngushtë edukatore-prind, për trajtim sa më të suksesshëm të vështirësive të fëmijës në të folur.

#### **Rekomandime për edukatoren**

1. Të respektojnë parimet bazë të edukimit parashkollor, zhvillimin e gjithanshëm të fëmijës dhe trajtimin individual të tyre sipas nevojave dhe vështirësive;
2. Të zbatojnë strategji që nxisin dhe zhvillojnë komunikimin verbal te fëmijët e grupit, posaçërisht te fëmijët që kanë vështirësi në të folur;
3. Të krijojnë mjedis të përshtatshëm dhe të përdorin mjete e materiale që nxisin të folurit e fëmijëve;
4. Të bashkëpunojnë me profesionistë dhe me asistentë (në rastet kur janë të angazhuar asistentë) për të zhvilluar komunikimin verbal te fëmijët që kanë vështirësi në të folur;
5. Të bashkëpunojnë me prindërit për të identifikuar me kohë dhe për të vlerësuar fëmijët me vështirësi në të folur dhe për të mbështetur fëmijën në zhvillimin e të folurit;
6. Të kërkojnë zhvillim profesional, për vështirësitë që u dalin gjatë punës me fëmijë me vështirësi në të folur.

#### **Rekomandime për prindër**

1. Të jenë të hapur, miqësorë dhe pa rezerva në informacione, sepse është në dobi të fëmijëve të tyre;
2. T'u përkushtojnë më shumë kohë fëmijëve dhe të përshtaten me interesat dhe nevojat e fëmijëve (të

flasin e debatojnë më shumë me ta për gjërat që i rrethojnë dhe me të cilat ballafaqohen konkretisht);

3. Të bëjnë përpjekje që të menaxhojnë përdorimin e mjeteve digjitale nga fëmijët;
4. Të bashkëpunojnë ngushtësisht me edukatorët për të ndarë informacione mbi zhvillimin gjuhësor të fëmijëve dhe për të krijuar një ekuilibër ndërmjet mbështetjes në shtëpi dhe në klasë.

## Bibliografia

- ASK. (2021). *Agjencia e Statistikave e Kosovës, Statistikat e arsimit në Kosovë, 2020/2021*.
- Bilton, H & Watts, M. (2020). *Early stem education: practice and prospects*.  
<https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/03004430.2019.1653547?tab=permissions&scroll=top>.
- Brebner et, al. (2016). Early childhood educators' understanding of early communication: Application to their work with young children. *Child Language Teaching and Therapy*.  
<https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1177/0265659016630034>.
- Brodin & Renblad. (2018). *Improvement of preschool children's speech and language skills*. Gjetur në  
<https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/03004430.2018.1564917>, datë 20.01.2022.
- Carton & Rosenback. (2019). *How to support multilingual children*. PEaCH.
- Chazan-Cohen et, al. (2017). *Working Toward a Definition of Infant/Toddler Curricula: Intentionally Furthering the Development of Individual Children within Responsive Relationships*.  
<https://researchconnections.org/sites/default/files/pdf/rc33657.pdf>
- Cohen, J. (2012). *Measuring and improving school climate: A pro-social strategy that recognizes, educates and supports the whole child and the whole school community*.  
[https://www.researchgate.net/publication/235342163\\_Cohen\\_J\\_2012\\_Measuring\\_and\\_improving\\_school\\_climate\\_A\\_pro-social\\_strategy\\_that\\_recognizes\\_educates\\_and\\_supports\\_the\\_whole\\_child\\_and\\_the\\_whole\\_school\\_community\\_The\\_Handbook\\_of\\_Prosocial\\_Education\\_Edite](https://www.researchgate.net/publication/235342163_Cohen_J_2012_Measuring_and_improving_school_climate_A_pro-social_strategy_that_recognizes_educates_and_supports_the_whole_child_and_the_whole_school_community_The_Handbook_of_Prosocial_Education_Edite).
- Conde, M. J. (2006). *Patterns of verbal communication in children with special needs. Dissertation Prepared for the Degree of Doctor of Education (Early Childhood Education)*.

- Crossman, A. (2019). *Përkufizimi i Profecisë Vetëpërbushëse*. Gjetur në <https://sq.eferrit.com/perkufizimi-i-profecise-vete-permbushese/>.
- ESSAYS. (2020). Effect of Environmental and Developmental Factors in Child Communication. *Effect of Environmental and Developmental Factors in Child Communication*, fv. <https://www.ukessays.com/essays/childcare/effect-of-environmental-and-developmental-factors-in-child-communication.php>.
- Fiechtner, J. (2017). *Supporting Language Development*. <https://www.communityplaythings.com/resources/articles/supporting-language-development>.
- Gooden, C & Kearns, J. (2013). *The Importance of Communication Skills*. <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED574738.pdf>.
- High Speed Training. (2021). *Supporting Language Development in the Early Years*. <https://www.highspeedtraining.co.uk/hub/supporting-language-development-in-the-early-years/>.
- Hirsh-Pasek & Golinkoff. (2012). *How babies talk: Six principles of early language development*. Gjetur në Hirsh-Pasek, K & Michnick Golinkoff, R. (2012) How babies talk: Six [https://www.researchgate.net/publication/258918293\\_How\\_babies\\_talk\\_Six\\_principles\\_of\\_early\\_language\\_development](https://www.researchgate.net/publication/258918293_How_babies_talk_Six_principles_of_early_language_development), date 29.01.2022.
- Icommunicatetherapy.com. (2013). *Activities to develop Speech and Language Skills*. <https://www.icommunicatetherapy.com/child-speech-language/child-speech-language-development/activities-strategies-help-develop-speech-language-skills/>.
- Illumine. (2022). *A guide to planning lessons for preschools*. <https://illumine.app/blog/a-guide-to-planning-lessons-for-preschools/>.
- Kilian-Ross, I. (2022). *The importance of making "eye contact" during early childhood*. South Afrika: <https://www.amazingk.co.za/the-importance-of-making-eye-contact-during-early-childhood/>.

- Light, & Drager. (2012). *Early Intervention*. Gjetur në <https://aackids.psu.edu/index.php/page/show/id/7/index.html>, datë, 29.01.2022.
- Mahliyo & Kizi. (2020). *THE DEVELOPMENT OF CHILDREN'S SPEECH IN A PRESCHOOL*. <https://www.idpublications.org/wp-content/uploads/2020/05/Abstract-THE-DEVELOPMENT-OF-CHILDRENS-SPEECH-IN-A-PRESCHOOL.pdf>.
- Mahn & Steiner. (2012). *Vygotsky and Sociocultural Approaches to Teaching and Learning*. Gjetur në Mahn, H., John-Steiner, V. (2012). *Vygotsky and Sociocultural Approaches to Teaching and Learning*, [https://www.researchgate.net/publication/233858620\\_Vygotsky\\_and\\_Sociocultural\\_Approaches\\_to\\_Teaching\\_and\\_Learning](https://www.researchgate.net/publication/233858620_Vygotsky_and_Sociocultural_Approaches_to_Teaching_and_Learning), datë, 25.01.2022.
- Marshall-Seslar, A. (2022). *50 Easy Language Development Activities for Toddlers*. <https://wellbeingwithalysia.com/language-activity-toddlers/>.
- MAShT. (2006). *Kurrikula për edukimin parashkollor*. Prishtinë.
- MAShT. (2016). *Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës*. Prishtinë: MAShT.
- MAShTI. (2006). *Kurrikula për edukimin parashkollor*. Prishtinë: MAShTI.
- MAShTI. (2006). *Ligji për edukimin parashkollor në Kosovë Nr. 02/L-52*. Prishtinë: MAShTI.
- MAShTI. (2011). *Ligji për arsimin parauniversitar në Kosovë Nr, 4/L32*. Prishtinë: MAShT.
- MAShTI. (2011). *Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç*. Prishtinë: MAShT.
- MAShTI. (2013). *Udhëzimi Administrativ - Përdorimi i Planit Individual të Arsimit*. Prishtinë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10137>.
- MAShTI. (2016). *Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor në Republikën e Kosovës*. Prishtinë.

- MASHTI. (2022, Shtator). *Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit*. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/02/IEAPP-licencim-rilicencim-WEB.docx>: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/02/IEAPP-licencim-rilicencim-WEB.docx>
- Meece, D., Rivers, L., & Wingate, K. (2009). *Environments: Strategies for promoting social development through positive guidance*. <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED507400.pdf>.
- NHS Ayshire & Arran. (2016). *Classroom strategies for children with communication difficulties*. <https://www.nhsaaa.net/media/1447/20170511cscdd.pdf>.
- Plakolli & Aliu-Gashi. (2016). *Bashkëpunimi edukator-prind në institucionet parashkollore të Kosovës*. Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- Presence.com. (2017). *Oral Language and Communication Skills in Early Childhood*. <https://presencelearning.com/insights/language-and-communication-skills-in-early-childhood/>.
- Reçica-Havolli & Mekolli. (2018). Roli i edukatoreve mbështetëse në institucionet parashkollore publike në Kosovë. *Kërkime Pedagogjike*. Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- Roberts et, al. (1991). Teachers' Use of Strategies to Facilitate the Communication of Preschool Children with Disabilities. *Journal of Early Intervention*.
- Rubie-Davies et al. (2006). Expecting the best for students: Teacher expectations and academic outcomes. [https://www.researchgate.net/publication/6836094\\_Expecting\\_the\\_best\\_for\\_students\\_Teacher\\_expectations\\_and\\_academic\\_outcomes](https://www.researchgate.net/publication/6836094_Expecting_the_best_for_students_Teacher_expectations_and_academic_outcomes).
- Scouten & Bardell. (2018). *Building Oral Language Skills through Classroom Instruction: Six High-Yield Strategies to Borrow from the Clinic*. Gjetur në Scouten, M.A & Bordell, T. (2018). Building Oral Language Skills through Classroom <https://www.ldatschool.ca/building-oral-language-skills/>, datë 20.01.2022.
- Sego, J. (2009). *The effect of environment on speech and communication competence in children; language games as an encouragement of child's speech development*. Gjetur në SeGo,

- J. (2009). The effect of environment on speech and communication competence in children; language games as an encouragement [https://www.researchgate.net/publication/297816313\\_The\\_effect\\_of\\_environment\\_on\\_speech\\_and\\_com](https://www.researchgate.net/publication/297816313_The_effect_of_environment_on_speech_and_com).
- Sierens & Avermaet. (2010). Diversiteit is de norm, er mee leren omgaan is de uitdaging: Een referentiekader voor omgaan met diversiteit in het onderwijs.  
[https://www.researchgate.net/publication/303460563\\_Diversiteit\\_is\\_de\\_norm\\_er\\_mee\\_leren\\_omgaan\\_is\\_de\\_uitdaging\\_Een\\_referentiekader\\_voor\\_omgaan\\_met\\_diversiteit\\_in\\_het\\_onderwijs](https://www.researchgate.net/publication/303460563_Diversiteit_is_de_norm_er_mee_leren_omgaan_is_de_uitdaging_Een_referentiekader_voor_omgaan_met_diversiteit_in_het_onderwijs).  
 Gjetur në  
[https://www.researchgate.net/publication/303460563\\_Diversiteit\\_is\\_de\\_norm\\_er\\_mee\\_leren\\_omgaan\\_is\\_de\\_uitdaging\\_Een\\_referentiekader\\_voor\\_omgaan\\_met\\_diversiteit\\_in\\_het\\_onderwijs](https://www.researchgate.net/publication/303460563_Diversiteit_is_de_norm_er_mee_leren_omgaan_is_de_uitdaging_Een_referentiekader_voor_omgaan_met_diversiteit_in_het_onderwijs).
- Swaril, G. S., Tantra, D. K., & Pratiwi, A. P.N. (2020). *Classroom Communication in Early Childhood Education*.  
[https://www.researchgate.net/publication/348896805\\_Classroom\\_Communication\\_in\\_Early\\_Childhood\\_Education](https://www.researchgate.net/publication/348896805_Classroom_Communication_in_Early_Childhood_Education).
- The Education Hub. (2019). *Strategies for supporting children's communication in educational settings*.  
<https://theeducationhub.org.nz/strategies-for-supporting-childrens-communication-in-educational-settings/>.
- The Little Dreams Nursery. (2022). *Why are communication skills important in child development?*  
<https://dreamersnursery.com/why-are-communication-skills-important-in-child-development/>.
- Tobars, P. (1997). *One Child, Two Languages: A Guide for Preschool Educators of Children Learning English as a Second Language*. ERIC.
- Tomilson & Hyson. (2009). *Developmentally Appropriate Practice in Early Childhood Programs, Third edition*. Washington, DC: NAEYC.
- UNICEF. (2022). *Key practice: Play and communication with children*. Uganda: <https://www.unicef.org/uganda/key-practice-play-and-communication-children>.
- Virtual Lab School. (2021). *Strategies for Promoting Communication*.  
<https://www.virtuallabschool.org/preschool/communication-and-language-development/lesson-4/act/17706>.



- Wahyuni, A. (2017). The Power of Verbal and Nonverbal Communication. - *Akhtim Wahyuni, 2018. The PoProceedings of the 1st International Conference on Intellectuals' Global Responsibility* . - Akhtim Wahyuni, 2018. The Power of Verbal and Nonverbal Communication in Learning. Proceedings of the 1st InternationAtlant.
- Willard, M. (2023). *Child not following directions*.  
<https://cadey.co/articles/follow-directions>.
- Wills, P. (2011). *Why invest in the pre-school years*. Gjetur në <http://www.parentingacrossscotland.org/media/253972/pas-the-best-place.pdf>, datë 29.01.2022.

## **Botues**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

## **Shtypi**

Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37:615.851-053.4(496.51)

Aliu-Gashi, Mevlude

Roli i edukatores në zhvillimin e komunikimit verbal te fëmijët  
parashkollorë me vështirësi në të folur / Mevlude Aliu-Gashi, Zehrie  
Plakolli. - Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2023. - 99 f. : ilustr.  
; 24 cm.

1. Plakolli, Zehrie

**ISBN 978-9951-591-66-9**

ISBN 978-9951-591-66-9



9 789951 591669